



## **Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare**

Studim kërkimor mbi investimet nga Diaspora dhe IHD-të nga Gjermania - Ndikimi në ekonominë e Kosovës

## **TABELA E PËRMBAJTJES**


<b>PËRMBLEDHJE E RAJONIT TË EJL – ANALIZA MAKROEKONOMIKE .....</b>	<b>5</b>
Rritja reale e PBB-së në Evropën Juglindore .....	5
Impakti i Covid-19 në PBB-në reale në Evropën Juglindore .....	5
Inflacioni në Evropën Juglindore .....	6
Norma e papunësisë në rajonin e Evropës Juglindore .....	6
<b>KËNDVËSHTRIMI EKONOMIK DHE PERSPEKTIVA NË KOSOVË .....</b>	<b>7</b>
PBB reale e Kosovës .....	7
Inflacioni i Kosovës .....	7
Popullësia e Kosovës .....	8
Fuqia punëtore e Kosovës .....	9
Tregtia ndërkombëtare e Kosovës .....	13
<b>INVESTIMET E HUAJA DIREKTE NGA GJERMANIA .....</b>	<b>16</b>
<b>INVESTIMET E HUAJA DIREKTE NË EVROPËN JUGLINDORE .....</b>	<b>20</b>
<b>IHD-TË E PARASHIKUARA NË EVROPËN JUGLINDORE.....</b>	<b>22</b>
<b>INVESTIMET E HUAJA DIREKTE NË KOSOVË.....</b>	<b>23</b>
<b>IHD-TË DHE “TË BËRIT BIZNES” .....</b>	<b>25</b>
<b>IMPAKTI SOCIAL I IHD-VE.....</b>	<b>27</b>
<b>LEGJISLACIONI FIKSAL NË KOSOVË .....</b>	<b>31</b>
<b>NDIKIMI I INVESTIMEVE GJERMANE DHE DIASPORË NË EKONOMINË E KOSOVËS .....</b>	<b>36</b>
<b>OPORTUNITETET E INVESTIMIT NË KOSOVË.....</b>	<b>39</b>
<b>PRAKTIKAT MË TË MIRA NË TËRHEQJEN E IHD-VE.....</b>	<b>45</b>

## Përmbledhja ekzekutive

Kosova është një shtet i vogël, i ri, në zhvillim, i vendosur në një zonë strategjike të Gadishullit Ballkanik, e kufizuar nga Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Serbia. Që nga shpallja e pavarësisë prej Serbisë në vitin 2008, Kosova ka punuar për të tërhequr investime të huaja direkte (IHD) si një mjet për rritjen e ekonomisë, veçanërisht në sektorët me potencial më të lartë, e parë kjo nga perspektivat gjeografike, nga strategjitë e përfitimeve kundrejt kostove, burimet natyrore etj.

Shtetet e tregjeve në zhvillim si Kosova, të cilave u mungojnë fondet nga qeveria, kanë përfitime të shumta nga Investimet e Huaja Direkte. IHD-të sjellin teknologji, njohuri teknike, aftësi manaxheriale, emra markash dhe një standard të caktuar që normalisht është më i lartë se ai në vendin pritës. Për më tepër, ata kontribuojnë përmes produkteve që krijojnë dhe ofrojnë, infrastrukturës, kapitalit njerëzor të punësuar dhe kapitalit direkt (monetar) të derdhur në vend. Teorikisht, këto priten të përkthehen në një rritje të konsumit dhe investimeve, në përmirësime të prodhimit dhe në PBB më të lartë.

Sipas të dhënave nga FMN, Kosova gjatë vitit 2019 regjistroi 124 EUR të ardhura neto të IHD-ve për frymë, ndërsa PBB-ja për frymë u regjistrua të jetë 3,932 EUR. Kjo e vendosi Kosovën në skajin më të ulët të spektrit të vendeve të krahasueshme në rajon, si për PBB-në për frymë, ashtu dhe për IHD-të për frymë. Sipas Bankës Botërore, për të tërhequr investime të huaja, një shtet duhet të ketë stabilitet ekonomik, politik, ligjor dhe social. Kosova paraqitet të ketë mungesa në të gjitha këto fusha, duke qenë se kompanitë ndërkombëtare theksojnë se janë ndeshur me trajtime të padrejta ligjore, korrupsion, pasiguri ligjore dhe politike, qeveri të paqëndrueshme dhe me mungesë të programeve të zhvillimit ekonomik. Në përgjithësi, një investitor i huaj duhet të ketë sigurinë se do të mbrohet nga rreziqet politike dhe rregullatore, se nuk do të shpronësohet dhe se do të ketë transparencë nga institucionet publike.



Biznese të shumta venë në pah se dhe shërbimet më themelore, si furnizimi me energji elektrike, nuk janë të garantuara. Për më tepër, infrastruktura është ende e pazhvilluar dhe e nën-investuar. Këta faktorë çojnë në rritje ekonomike nën-normalen dhe kanalizojnë zhvillimin e investimeve të huaja drejt vendeve të tjera. Nga ana tjetër, grafiku i mësipërm tregon se flukset neto të IHD-ve nuk kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme në PBB-në për frymë të Kosovës. Gjatë vitit 2019, Bosnja & Hercegovina si dhe Turqia regjistruan përkatësisht 106 EUR dhe 94 EUR flukse neto për frymë, por gjithashtu një PBB më të madhe për frymë, prej 5,454 EUR dhe 8,176 EUR përkatësisht. Në Shqipëri, në mënyrë të ngjashme me Kosovën, kontributi i flukseve neto të IHD-ve në PBB-në për frymë në 2019 ishte shumë i ulët, pasi u regjistruan 374 EUR investime hyrëse neto për frymë dhe 4,753 EUR PBB për frymë. Ndërkohë, duke qenë një anëtare e Bashkimit Evropian, ndikimi më i madh i flukseve neto të IHD-ve në rajon për 2019 ishte në Slloveni, përkatësisht me 738 EUR investime hyrëse për frymë dhe 23,390 EUR

PBB për frymë. Nga pikëpamja e analizës referuese dhe krahasimore, këto rezultate kontradiktore mund të kenë rrjedhur si pasojë e politikave fiskale dhe politike, duke marrë parasysh që stabiliteti është një tregues kryesor për investitorët. Gjithashtu, pengesat kufitare ndaj vendeve të BE-së, mungesa e mbështetjes strategjike të investimeve nga qeveritë dhe faktorë të tjerë të shumtë mund të kenë qenë nxitës të këtyre rezultateve. Për më tepër, duhet theksuar se për një vend është e rëndësishme të tërheqë llojin e duhur të Investimeve të Huaja Direkte. Përndryshe, ata jo vetëm që nuk do të kontribuojnë në rritjen e PBB-së së vendit, por mundet fare mire të transferojnë ose përjashtojnë investimet e brendshme dhe të pengojnë formimin e kapitalit, duke pasur një ndikim të kundërt me atë të synuar.

Sipas asaj çfarë Anabel Gonzales, Drejtore e Lartë për Tregtinë dhe Konkurrencën në Bankën Botërore, ka deklaruar në një nga Raportet e Konkurrencës Globale së Investimeve, "konkurrenca e investimeve e një shteti shkon përtej tërheqjes së IHD-ve. Ajo përcaktohet nga aftësia e shtetit për të sjellë, mbajtur dhe shfrytëzuar investime private për një rritje ekonomike gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme." Qartësisht, rezultatet e paraqitura në grafik paralajmërojnë për një paaftësi të vendeve për të mbajtur investitorët e duhur të huaj".

Kosova ka mundësi të mëdha investimi në energji dhe miniera, bujqësi dhe blegori, ndërtim, tekstile dhe turizëm. Është e rëndësishme që të vendosen stimuj për të tërhequr llojet e duhur të IHD-ve, që këta të fundit të përcjellin njohuritë teknike (know-how), aftësitë manaxheriale dhe kapitalin për investim në këta sektorë, dhe që paralelisht së bashku me reformat dhe transparencën qeveritare të sigurohet që këto IHD të përkthehen në rritje më të lartë ekonomike.

## **Përmbledhja ekzekutive e sondazhit**

Studimi kërkimor kishte në fokus kompanitë që investojnë në Kosovë me kapital gjerman (operative ose jo), që operojnë në sektorë të ndryshëm. Sondazhi u shpërnda në 161 biznese, por vetëm 31 biznese e plotësuan atë. **Për detaje të sondazhit, ju lutem referohjuni Shtojcës 4.**

Sondazhi pati si qëllim shënjestrimin e kompanive që kanë një fare forme pjesëmarrjeje të huaj dhe operojnë në sektorë të ndryshëm veprimtarie.

Disa nga gjetjet kryesore të sondazhit janë si më poshtë:

- Sipas sondazhit, rezultoi se 71% e të anketuarve janë me kombësi gjermane. Shumica e tyre operojnë në industrinë e Shërbimeve, ndërsa për ata me kombësi kosovare, fokusi kryesor i investimeve është industria prodhuese dhe ndërtimi (detaje të mëtejshme rreth sektorëve kryesorë të operimit mund të gjenden në Shtojcën 5).
- Kompanitë me kapital më të vogël të investuar, operojnë kryesisht në industrinë e shërbimeve dhe gjithashtu kanë një numër më të ulët të punonjësve. Nga ana tjetër, ata që kanë investuar sasi të mëdha kapitali janë të përqëndruar në prodhim dhe ndërtim, në energji dhe shërbime financiare-bankare dhe këshilluese, si dhe kanë një numër më të madh të punonjësve.
- Të dhënat e sondazhit treguan se ndërmarrjet në operim prej 1-4 vitesh janë përgjigjur se pengesa më e madhe që hasin janë barrierat administrative; ato me 5-10 vjet veprimtari operative përcaktuan se sistemi ligjor dhe gjyqësor ishte pengesa më e madhe; ndërsa kompanitë që operojnë për më shumë se 10 vjet cilësuan korrupsionin si vështirësinë kryesore me të cilën përballen.
- Në sektorin e energjisë, 75% e të anketuarve cilësuan aftësitë e fuqisë punëtore si pengesën kryesore me të cilën përballen, në industrinë e prodhimit 78% përcaktuan korrupsionin, në industrinë e shërbimeve 63% iu referuan pengesave administrative, në shërbimet financiare 50% përcaktuan systemin ligjor dhe gjyqësor dhe pjesa tjetër prej 50% në teknologjinë e informacionit e konsideruan besueshmërinë institucionale si pengesën kryesore me të cilën ndeshen.
- Sipas studimit, arsyeja kryesore për të cilën është investuar në Kosovë, u cilësua të jetë fuqia punëtore me 39% të të anketuarëve.
- Lidhur me pritshmëritë për të ardhmen, sondazhi tregoi se fuqia punëtore vazhdon të shihet si mundësi kryesore me 33%. Nga ana tjetër, kërcënimet kryesore u cilësuan të ishin faktorët politikë me 26%.

# **PËRMBLEDHJE E RAJONIT TË EVROPËS JUGLINDORE – ANALIZA MAKROEKONOMIKE**

**Shënim i seksionit: Ky seksion ofron një pasqyrë makroekonomike të rajonit të EJL, me qëllim vënien në perspektivë të Kosovës me vendet e tjera të rajonit. 12 vendet e EJL janë cilësuar si të përshtatshme për analizën tonë, në mbështetje të analizës së IHD-ve gjermane ndaj këtyre vendeve, trajtuar në seksionet e mëposhtme të këtij raporti.**

## **Rritja reale e PBB-së në Evropën Juglindore**

Rajoni i Evropës Juglindore, referuar grupit prej 12 shteteve siç paraqitet në grafikun më poshtë, regjistroi një rritje mesatare të PBB-së prej 3.5% në 2019, që përkon me një rënie me 0.4% në krahasim me rritjen prej 3.9% në 2018. Arsyeja kryesore e rënies ishte përkeqësimi i mjedisit të jashtëm që nga fillimi i vitit 2018, me volume më të zbutura të tregtisë globale dhe pasiguri të lartë gjeopolitike. Megjithatë, në vitin 2020, bazuar në parashikimet e FMN-së, parashikohet një rënie mesatare e PBB-së prej -6.0% për rajonin, e njëjtë me Gjermaninë. Ndërkohë PBB-ja e Kosovës parashikohet të tkurret me 7.5% në vitin 2020, 1.5% më shumë se rajoni. Kjo rënie e konsiderueshme pritet kryesisht si pasojë e pandemisë së Covid-19.

### **Rritja reale e PBB**

%	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021p
Shqipëria	2.2%	3.3%	3.8%	4.1%	2.2%	(7.5%)	6.1%
Bosnjë dhe Hercegovinë	3.1%	3.1%	3.2%	3.7%	2.7%	(6.5%)	5.0%
Bullgaria	4.0%	3.8%	3.5%	3.1%	3.4%	(4.0%)	4.1%
Kroacia	2.4%	3.5%	3.1%	2.7%	2.9%	(9.0%)	6.0%
Kosova	4.1%	4.1%	4.2%	3.8%	4.0%	(7.5%)	6.0%
Moldavia	(0.3%)	4.4%	4.7%	4.0%	3.6%	(4.5%)	4.1%
Mali i Zi	3.4%	2.9%	4.7%	5.1%	3.6%	(12.0%)	5.5%
Maqedonia e Veriut	3.9%	2.8%	1.1%	2.7%	3.6%	(5.4%)	5.5%
Rumania	3.9%	4.8%	7.1%	4.4%	4.1%	(4.8%)	4.6%
Serbia	1.8%	3.3%	2.0%	4.4%	4.2%	(2.5%)	5.5%
Slovenia	2.2%	3.1%	4.8%	4.1%	2.4%	(6.7%)	5.2%
Turqia	6.1%	3.3%	7.5%	3.0%	0.9%	(5.0%)	5.0%
<b>Gjermania</b>	<b>1.5%</b>	<b>2.2%</b>	<b>2.6%</b>	<b>1.3%</b>	<b>0.6%</b>	<b>(6.0%)</b>	<b>4.2%</b>
<b>Mediana - EJL12</b>	<b>3.2%</b>	<b>3.3%</b>	<b>4.0%</b>	<b>3.9%</b>	<b>3.5%</b>	<b>(6.0%)</b>	<b>5.3%</b>

Burimi: Fondi Monetar Ndërkombtar, Dhjetor 2020

## **Impakti i Covid-19 në PBB-në reale në Evropën Juglindore**

Sipas FMN-së, Evropa po shkon drejt një recesioni historik, si pasojë e uljes së prodhimit dhe konsumit në gjysmën e parë të vitit 2020 nga Covid-19 dhe masave të kontrollit të vëna në zbatim. Mali i Zi pritet të përballlet me tkurrjen më të thellë në Evropën Juglindore, duke marrë parasysh numrin e lartë të rasteve dhe masave relativisht të rrepta të izolimit. Më specifikisht, FMN parashikon që rritja e PBB-së së Malit të Zi të jetë më e ulta në rajon me -12.0% në 2020, një rënie prej rreth 15.6% nga 2019. Serbia nga ana tjetër, parashikohet të përballlet me një PBB prej -2.5% në 2020 për shkak të efekteve të pandemicë, që është ulja më e vogël në rajon. Zinxhirët e ofertës globale pritet të qëndrojnë të përcarë, papunësia dhe dështimet e bizneseve pritet të vazhdojnë të rriten dhe që konsumatorët të qëndrojnë të kujdesshëm. Shtete si Shqipëria, Kroacia dhe Mali i Zi, që varen nga turizmi, pritet të përballen me vështirësitë për më gjatë pasi masat e karantinës dhe ato të tjera kufizuese që po zbatohen nga autoritetet mund të zbrapsin pushuesit. Normat e rritjes sipas EIU parashikohet të rikuperohen në 2021, por kjo do të lejojë vetëm një rimëkëmbje të pjesshme.

## **Inflacioni në Evropën Juglindore**

Bazuar në FMN, presionet e përgjithshme të çmimeve në rajonin e EJL ndikuan në paqëndrueshmërinë e shfaqur në nivelet e çmimeve gjatë 2015 - 2019. Mediana e inflacionit të llogaritur mbi çmimet e konsumit në fund të periudhës, bazuar në grupin e 12 vendeve të EJL, u ul në 1.6% në 2019, nga 1.7% në 2018. Bazuar në vlerësimet e FMN-së, mediana e inflacionit të rajonit të EJL parashikohet të vazhdojë të ulët në vitin 2020, duke arritur 1.1%, ndërsa një rritje e lehtë pritet për vitin 2021, me inflacionin e parashikuar në 1.8%, që është 0.6% më shumë se pritshmëria në Kosovë dhe Gjermani përkatësisht.

Pavarësisht nga tendencat e medianes të përshkruara më sipër, presionet inflacioniste janë karakterizuar nga diferenca të konsiderueshme rajonale, veçanërisht në shtetet e Eurozonës, shtetet që kanë një kurs fiks këmbimi me Euron, ose në vende si Bullgaria, Kroacia dhe shtetet e Ballkanit Perëndimor, në të cilat bankat qendrore kufizojnë luhatjet ndaj Euros. Si pasojë, presionet inflacioniste kanë qenë të zbutura. Këto ekonomi ndjekin ngushtësisht ciklin ekonomik të Eurozonës dhe pritshmëritë e inflacionit kanë tendencën të lëvizin në një hap me ato të bllokut të monedhës unike. Në përgjithësi, sipas gjetjeve të FMN-së, ndërprerja e furnizimeve e shkaktuar nga pandemia ka kompensuar dhe ka tejkaluar presionet zbritëse të çmimeve të rrjedhuara nga rënia e kërkesës së konsumatorëve, duke bërë që çmimet në sektorët kryesorë të mallrave dhe shërbimeve të bien në terma vjetorë.

### **Rajoni EJL - Inflacioni (çmimet aktuale)**

%	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021p
Shqipëria	1.9%	2.2%	1.8%	1.8%	1.2%	1.2%	2.2%
Bosnjë dhe Hercegovinë	(1.3%)	(0.5%)	0.7%	1.6%	0.7%	(0.8%)	0.4%
Bullgaria	(0.9%)	(0.5%)	1.8%	2.3%	3.1%	0.5%	2.4%
Kroacia	(0.6%)	0.2%	1.2%	0.9%	1.4%	0.2%	0.9%
Kosova	(0.1%)	1.3%	0.5%	2.9%	1.2%	1.5%	1.2%
Moldavia	13.5%	2.4%	7.3%	0.9%	7.5%	0.5%	6.0%
Mali i Zi	1.4%	1.0%	1.9%	1.7%	1.1%	(0.4%)	0.9%
Maqedonia e Veriut	(0.4%)	(0.2%)	2.4%	0.8%	0.4%	1.0%	1.4%
Rumania	(0.9%)	(0.5%)	3.3%	3.3%	4.0%	2.7%	2.7%
Serbia	1.6%	1.5%	3.0%	2.0%	1.9%	1.6%	2.0%
Slovenia	(0.5%)	0.5%	1.8%	1.4%	1.8%	1.2%	1.6%
Turqia	8.8%	8.5%	11.9%	20.3%	11.8%	12.0%	12.0%
<b>Gjermania</b>	<b>0.2%</b>	<b>1.7%</b>	<b>1.5%</b>	<b>1.8%</b>	<b>1.5%</b>	<b>0.3%</b>	<b>1.2%</b>
<b>Mediana - EJL12</b>	<b>(0.2%)</b>	<b>0.8%</b>	<b>1.8%</b>	<b>1.7%</b>	<b>1.6%</b>	<b>1.1%</b>	<b>1.8%</b>

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe Fondi Monetar Ndërkombtar, Dhjetor 2020

## **Norma e papunësisë në rajonin e Evropës Juglindore**


Papunësia mediane në rajonin e EJL sipas botimeve të FMN ra në nivele të ulta historike gjatë vitit 2019 duke arritur në 9.3%, me një rënie prej 1.1% krahasuar me 10.5% të shfaqur në 2018. Rumania regjistroi nivelin më të ulët të papunësisë në 2019 me 3.9%, ndërsa norma më e lartë rezultoi në Maqedoninë e Veriut me 17.3%. Pas vështirësive të shkaktuara nga pandemia e koronavirusit, norma mediane e papunësisë në Rajon pritet të arrijë c. 10.5% në vitin 2020. Duke u vënë përballë pritshmërisë së dështimit të një pjese të konsiderueshme firmave, qeverive do t'u paraqitet një zgjedhje e vështirë midis:

- Parandalimit të një krize borxhi të korporatave dhe një rritjeje të mundshme të papunësisë;
- Dhe mos mbështetjes së firmave që janë të paqëndrueshme dhe mund të pengojnë rritjen ekonomike në të ardhmen.

Sidoqoftë, ndihma sociale e kufizuar qeveritare për shkak të Covid-19 dhe tregjet e nënzhvilluara të kapitalit do të zmadhojnë rënien e konsumit privat në përgjigje të një rritjeje të papunësisë.



Rajoni EJL- Norma e papunësisë (në %)



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar, Dhjetor 2020

## VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I EKONOMISË DHE PERSPEKTIVAVE NË KOSOVË

**Shënim i seksionit:** Ky seksion jep një shqyrtim të mëtejshëm të faktorëve makroekonomikë, me një fokus specifik në Kosovë dhe në treguesit kryesorë që shpesh trajtohen si indikatorë matës kur çmohen efektet e investimeve të huaja direkte.

### PBB reale e Kosovës

Në mënyrë të ngjashme me vendet e tjera në rajon, në Kosovë ekonomia përjetoi një tkurrje në vitin 2020, pavarësisht heqjes së masave të kontrollit gjatë tremujorit të dytë të vitit. Përveç mbylljes së përkohshme të aktiviteteve kryesore ekonomike dhe humbjes së të ardhurave përkatëse, ndikimi i pandemisë në Kosovë u shoqërua kryesisht me uljen e eksporteve të shërbimeve të influencuara nga diaspora, u e remitancave informale dhe IHD-ve në ndërtimin e banesave. Sidoqoftë, ekonomia pritet të rimëkëmbet në vitin 2021. Gjithsesi, nëse shpërhapja së pandemisë do vazhdojë përtej tremujorit të parë të vitit 2021, efektet e COVID-19 do të prekin më shumë anën ofertuese të ekonomisë, duke rrjedhur në humbje afatgjata në vendet e punës dhe prodhim.


Bazuar në të dhënat e BQK-së, në vitin 2019 rritja e PBB-së në Kosovë ishte 4.0%, që përbën një rritje prej 0.2% në krahasim me rritjen prej 3.8% të 2018. Rritja e PBB-së e përjetuar në Kosovë, ndikoi në rritjen e konsoliduar të periudhës 2016-2019 me një norme vjetore mesatare rritje (CAGR) prej - 0.6%. Sipas BQK-së, rigjallërimi i investimeve të nxitura nga rritjet e huave bankare dhe remitancave ishin treguesit kryesorë për rritjen e PBB-së deri në vitin 2019. FMN parashikon që PBB-ja e Kosovës të tkurret me një normë prej -7.5% në vitin 2020 duke u rimëkëmbur në 2021 me 6.0%. Rënia relativisht e madhe e PBB-së në vitin 2020 ndikohet kryesisht nga efektet e pandemisë së Covid-19. Sidoqoftë, kërkesa e brendshme për konsum mbeti e lartë pasi remitancat, pagat dhe pensionet vazhduan të rriten deri në periudhën e kufizimeve dhe mbylljes nga pandemia Covid-19.

### Inflacioni i Kosovës

Sipas BQK-së, në vitin 2019, inflacioni i matur nëpërmjet IÇK si ndryshimi në përqindje i çmimit të konsumit në fund të periudhës, u regjistrua më i fortë dhe konsiderueshëm më i ulët se një vit më parë, specifikisht duke u ulur nga 2.9% në 2018 në 1.2% në 2019. Për më tepër, në krahasim me normën mediane të rajonit prej 1.6% në 2019, inflacioni i regjistruar në Kosovë ishte rreth 0.4% më i ulët. Ndërsa, sipas pritshmërive të FMN-së, në vitin 2020 norma e inflacionit të Kosovës pritet të arrijë 1.5%

ndërsa norma mediane e rajonit pritet të mbetet e ulët në rreth 1.1% dhe c. 40 pikëbaze nën inflacionin e Kosovës. Sipas FMN, në vitin 2019, trendet e inflacionit u ndikuan kryesisht nga rritja e çmimit të shportës së ushqimeve dhe shërbimet e akomodimit. Gjithsesi, para vitit 2018 çmimet ishin përgjithësisht të ulta në ekonomi, kjo sepse oferta e mallrave mund të ketë qenë më e lartë se kërkesa respektive, ndikuar gjithashtu potencialisht dhe nga rritja e fuqisë blerëse të parasë gjatë 2015-2019. Lulatja e çmimeve në Kosovë pritet të vazhdojë të jetë në varësi të çmimeve të tregjeve ndërkombëtare, veçanërisht nga tregu Evropian, për sa kohë që ekziston një varësi e lartë e ekonomisë ndaj importeve nga rajoni.

### Kosovë - Rritja ekonomike dhe Inflacioni




Burimi: Fondi Monetar Ndërkombëtar, Dhjetor 2020

### Popullsia e Kosovës

Sipas ASK, popullsia e Kosovës ka shfaqur tendenca të qëndrueshme rritjeje në nivele shumë të vogla me CAGR prej 0.4% gjatë 2017 - 2019. Përkatësisht, në 2019 popullsia e Kosovës arriti në 1.80 mln njerëz, nga të cilët 49.5% ishin meshkuj dhe 50.5% femra. Gjatë së njëjtës periudhë, niveli i lindjeve ishte 1.5%, duke përbërë një rënie me 0.4% në krahasim me normën e lindjes prej 1.9% të vitit 2018. Parashikimet e ASK reflektojnë një pritshmëri për rritje të butë popullesisë së Kosovës deri në 1.82 mln në 2025, si rezultat i rritjes së jetëgjatësisë dhe normave të lindjeve. Nga ana tjetër, dominimi i femrave pritet të jetë prezent pothuajse në të njëjtat nivele nga viti 2019 deri në vitin 2025. Sipas EIU, përafërsisht 25% e popullsisë ishin në grup-moshën 0-14 vjeç në 2019, duke e bërë kështu popullsinë e Kosovës një nga popullsitë më të reja në Evropë dhe rajon.






Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, Dhjetor 2020

## Fuqia punëtore e Kosovës

Sipas sondazhit të ASK për forcën punëtore, pjesëmarrja në fuqinë punëtore në Kosovë ka qëndruar rreth 40% që nga 2016, (40.5% në 2019) ndërsa rëniet në nivelet e larta të normës së papunësisë dhe fitimet në punësim kanë qenë të shkurtra dhe kanë ndjekur modele sezonale. Të dhënat e vitit 2019 sugjerojnë një pikë të shndritshme në tregun e punës së Kosovës pasi norma e papunësisë ra në 25.7% nga 29.6% e një viti më parë, ndërsa norma e punësimit u rrit në 30.1% nga 28.8% përgjatë të njëjtës periudhë.


Bazuar në ASK, ky përmirësim u ndikua pjesërisht nga krijimi i vendeve të përkohshme të punës si pasojë e përgatitjeve për zgjedhje. Hendeku i gjerë midis niveleve të punësimit të meshkujve dhe femrave (përkatesisht 49% dhe 14%) vazhdoi të qëndronte. Normat shumë të larta të pasivitetit (59.5%), në veçanti pasiviteti i femrave (78.9%) dhe papunësia e të rinjve (49.4%) sugjerojnë egzistencën e punëve të padeklaruara dhe një mospërputhje mes niveleve të arsimit dhe nevojave të tregut të punës. Emigrimi i punëtorëve të kualifikuar përbën një sfidë të rëndësishme për perspektivat ekonomike afatmesme. Politikat aktive të tregut të punës, skemat e para-kualifikimit dhe programet e trajnimit profesional mbeten të pamjaftueshme për nevojat e tregut të punës.



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, Dhjetor 2020


ASK raportoi se në vitin 2019 në Kosovë ishin 43.4 mijë persona të papunësuar të moshave 15 - 24 vjeç, pra 1.4 mijë më pak se 42 mijë personat e papunësuar të moshave 25 - 34 vjeç. Sidoqoftë, në vitin 2019 Kosova regjistroi 20.3 mijë njerëz të papunë të moshës 35 - 44 vjeç, të përbërë nga 72.4% meshkuj dhe 27.6% femra. Popullariteti i papunësisë mashkullore mbetet i pranishëm edhe në grupmoshat (15 - 24) dhe (25 - 34), me 60.4% dhe 60.2% përkatësisht. Në përgjithësi, norma e papunësisë në Kosovë shfaq tendencën për t'u zvogëluar me rritjen e moshës, duke krijuar kështu një lidhje negative ndërmjet dy variablave.

### Kosovë - Papunësia (në mijë) sipas moshës në 2019




Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, Dhjetor 2020

### Kosovë - Të dhënat e punësimit sipas moshës dhe gjinisë në 2019




Burimi: ASK, Dhjetor 2020


Niveli i punësimit i regjistruar në Kosovë gjatë vitit 2019 ishte në çekuilibër domethënës, me dominimin e meshkujve të pranishëm në nivele të larta sipas publikimeve të ASK. Numri më i ulët i 44.5 mijë njerëzve u regjistrua për moshën midis (15 - 24) vjeç, 74.6% e përbërë nga meshkuj dhe 25.4% nga femra. Gjatë të njëjtit vit në Kosovë u regjistruan 91.9 mijë dhe 85.8 mijë persona të punësuar respektivisht, të moshës ndërmjet (25 - 34) dhe (35 - 44) vjeç, ku femrat ishin në nivele të ulëta sa 21,7 mijë dhe 21,2 mijë përkatësisht. Bazuar në BQK, shumica e njerëzve të punësuar konsistojnë në meshkuj të moshës ndërmjet (25 - 34) vjeç. Në mënyrë të ngjashme, meshkujt e moshës ndërmjet (25 - 29) vjeç ishin shumë të pranishëm edhe në normën e pjesëmarrjes në punë, ndjekur nga e njëjta gjini në moshën ndërmjet (30 - 34) vjeç, duke konsistuar përkatësisht në 68.4% dhe 74.9%.




Sipas publikimeve të ASK-së mbi statistikat e papunësisë me fokus në arsimin e mesëm profesional, Kosova në vitin 2019 regjistroi 53.6 mijë persona, në krahasim me 61.8 mijë në 2017 dhe 57.1 mijë në 2018. Në vitin 2019, 73.5% e papunësisë ishte e përbërë nga meshkuj dhe 26.5% nga femra.



Ndërsa në vitin 2019, niveli i përgjithshëm i të punësuarëve me arsim të mesëm profesional (i përbërë nga 73.5% meshkuj dhe 26.5% femra) shënoi normën më të ulët të papunësisë si të meshkujve ashtu dhe femrave që nga viti 2015. Sipas ASK, të dhënat e 2019 kanë treguar që mbizotërimi i meshkujve në papunësinë sipas arsimit të mesëm profesional, ka qenë prezent që nga viti 2015. Gjatë kësaj periudhe shkalla e papunësisë tek meshkujt u ul me një normë vjetore mesatare CAGR prej 4,5%, shkalla e femrave u rrit me normë vjetore mesatare CAGR 2,6% dhe në terma të përgjithshëm për këtë nivel arsimit u regjistrua një ulje vjetore mesatare e shkallës së papunësisë prej 2,9%.




Sipas ASK, Kosova regjistroi 17.2 mijë njerëz të papunësuar me arsim të mesëm në 2019, duke sjellë një rënie me 16.2 mijë në krahasim me 33.4 mijë në 2018. Dominimi i meshkujve në papunësi ishte i pranishëm gjatë periudhës në shqyrtim, ku në 2019 arriti në 63.4% ose 10.8 mijë persona (përkatesisht 36.6% dhe 6.4 mijë femra). Papunësia e përgjithshme sipas arsimit të mesëm shfaqti një rënie me normë mesatare CAGR prej 10.3%, prej të cilës meshkujt ranë me 12.4% dhe dhe femrat me 6.1% gjatë 2015 në 2019.




Dominimi i meshkujve ndaj femrave në nivelin e papunësisë sipas arsimit të lartë u zbeh relativisht gjatë 2015 - 2019 sipas ASK. Në vitin 2019, 28.4 mijë njerëz u regjistruan si të papunësuar me arsim të lartë, nga të cilët 61.6% ishin femra dhe 38.4% meshkuj. Ndryshe nga llojet e tjera të arsimit, shkalla e papunësisë në arsimin e lartë u rrit me një normë vjetore mesatare CAGR prej 10.4% gjatë 2015 - 2019. Për më tepër, shkalla e papunësisë së femrave u rrit me një CAGR prej 13.4%, një rritje thuajse e dyfishtë krahasuar me rritjen prej 6.7% të shfaqur tek meshkujt në njëjtën kornizë kohore.

## TREGTIA NDËRKOMBËTARE E KOSOVËS

Në vitin 2019, Kosova importoi përafërsisht 3.50 miliard Euro mallra dhe shërbime, krahasuar me eksportet që arritën në 0.33 miliard Euro, ku kontribuesit kryesorë të eksportit ishin hekuri dhe çeliku (rreth 19,7%), ndjekur nga plastika dhe përbërësit e saj (rreth 12,6%). Në vitin 2019, eksportet u rritën me c. 2.7%, ndikuar kryesisht nga shërbimet e udhëtimit për diasporën e Kosovës, duke rezultuar në një përmirësim në deficitin e llogarisë rrjedhëse. Sipas FMN-së, eksportet e Kosovës parashikohen të rriten në mënyrë të konsiderueshme gjatë gjithë periudhës 2020 - 2025. Importet parashikohen të shfaqin të njëjtën tendencë. FMN parashikon që bilanci i llogarisë rrjedhëse të Kosovës të zvogëlohet gjatë gjithë viteve 2020-2025, me një normë vjetore mesatare CAGR prej 1.9%, duke arritur rreth 0.55 miliardë euro në 2025 ose 4.2% të PBB-së, pra 1.3% më pak krahasuar me 5.5% të PBB-së në 2019.



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, Dhjetor 2020




Burimi: Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), Dhjetor 2020

Gjatë vitit 2019, importet nga Gjermania që është vendi më i madh importues përbënin 12.8% të importeve totale të Kosovës. Vendet e tjera kryesore importuese, siç tregohet në grafik, vijnë nga rajoni i EJK-12. Nga ana tjetër, bazuar në të dhënat e ASK, 17.6% e totalit të eksporteve të Kosovës përqëndrohen në Shqipëri, ndjekur nga 11.5% në Maqedoninë e Veriut. Shumica e eksporteve kanë të bëjnë me vendet fqinje, por 8.1% e tyre ishin në Gjermani në 2019. Eksportet në Zvicër arritën 7.4%, që përbën rreth 4.5% më pak se Britania e Madhe.


Sipas botimeve të ASK, industria e produkteve minerale rezultoi me sasinë më të lartë në eksporte dhe importe përkatësisht me 25.4% dhe 45.5%. Sidoqoftë, industria e Makinerisë dhe Transportit shënoi sasinë e dytë më të lartë të eksportit me 21.3%, pasuar nga produktet e industrisë kimike dhe ushqimeve & pijeve me 13.4% dhe 12.06% përkatësisht. Lidhur me importet, produktet e industrisë kimike u renditën si industria e dytë me 15.4% ndjekur nga ushqimi dhe pijet me 10.4%.

### Kosova - Importet sipas Vendeve në 2019



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, Dhjetor 2020


### Kosova - Eksportet sipas shteteve në 2019



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, Dhjetor 2020




## Kosovë - Eksport / Import sipas industrisë në 2019



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, Dhjetor 2020

## INVESTIMET E HUAJA DIREKTE NGA GJERMANIA

[Shënimi i Seksionit: Ky seksion paraqet një përmbledhje të investimeve të huaja direkte pare nga një perspektivë gjermane. Informacioni në lidhje me vendet ku Gjermania investon do të na japë një kuptueshmëri të strategjive gjermane, të sektorëve ku investitorët gjermanë fokusohen më shumë për të përmbushur nevojat e tyre dhe për qëllimet strategjike të ekonomisë, si nga një perspektivë sektoriale (prodhuese, tregtare, financiare etj.) ashtu dhe ato gjeografike/politike (Globale, vendet e BE-së përkundrejt vendeve jo-anëtare të BE-së, EJL). Kjo do të na ndihmojë më tej në vlerësimin e potencialit të investimeve të ardhshme gjermane në Kosovë, dhe të mundësive që ka Kosova në tërheqjen e këtyre investimeve.]




Burimi: Banka Federale Gjermane, Dhjetor 2020

Shënim\*: - 2018 përfaqëson vitin e fundit të të dhënave të disponueshme nga Banka Federale Gjermane

Sipas Deutsche Bundesbank (d.m.th. Banka Federale e Gjermanisë, në vazhdimësi DB), gjatë vitit 2018, niveli i përgjithshëm i fondeve të IHD-ve të jashtme Gjermane arriti në 1,276.9 miliardë EUR, duke shfaqur një rritje prej 5.8% nga viti 2017 (1,206.5 miliardë EUR). Rajoni më i preferuar për investitorët gjermanë ishte Evropa me një nivel investimesh prej 634,9 miliard Eurosh. Këto investime përbënin 49.7% të stokut të përgjithshëm të IHD-ve të jashtme gjermane dhe shfaqën një rritje vjetore me 3.6% krahasuar me nivelin e investimeve të vitit 2017 (612.9 miliardë). Pjesa e dytë më e madhe e fondeve të IHD-ve të jashtme gjermane përbëhej nga rajoni amerikan (rreth 34.0%). Këto investime shfaqën një rritje me 10.4%, nga 392.6 miliard Euro në 2017 në 433.6 miliard Euro në 2018. Investimet në Azi gjatë kësaj periudhe përbënin 13.8% të totalit, ndërsa Afrika, Oqeani dhe rajone të tjera zunë bashkërisht më pak se c.2.5% të IHD-ve të jashtme totale. Në total, fondi i IHD-ve të jashtme gjermane u rrit me një normë mesatare vjetore CAGR prej 6.6% gjatë 2015-2018, me rritjen më të lartë të shfaqur në rajonin e Afrikës (8.3%) dhe më të ultën në Oqeani dhe rajonet polare (2.6%).

## PËRBËRJA E FONDEVE TË IHD-ve GJERMANE DALËSE NË RAJONIN EVROPIAN (BE DHE JO BE)




Burimi: Banka Gjermane Federale, Dhjetor 2020

Sipas informacionit të siguar nga DB, për sa i përket fondeve në rajonin Evropian, investitorët gjermanë historikisht kanë shfaqur një preferencë ndaj Shteteve Anëtare të BE-së, duke qëndruar mesatarisht në nivelet e 85.3% të totalit të aktiveve të rajonit Evropian gjatë 2015-2018.

Në të njëjtën periudhë kohore, kapitali gjerman në vendet e BE është rritur me një normë mesatare vjetore CAGR prej 7.9%, duke çuar në një rritje të proporcionit të zënë nga vendet anëtare të BE nga 84.6% në 2015 në c. 86.0% në 2018. Në të kundërt, fondet e vendeve jo-BE u rritën me një ritëm më të ngadaltë prej 3.8%, duke çuar në një tkurrje të proporcionit të zënë nga 15.4% në 14.0% të kapitalit total të rajonit Evropian gjatë 2015-2018.

Gjatë vitit 2018, fondet e dalëse gjermane në vendet jo-BE përbënin 14.0% të kapitalit të investuar në rajonin Evropian dhe shfaqën një rritje vit pas viti me 2.5% në krahasim me 2017 (86.7 miliardë euro).

## PËRBËRJA E FONDEVE TË IHD-ve GJERMANE DALËSE NË RAJONIN EVROPIAN (EJL dhe vendet e tjera evropiane)




Burimi: Banka Gjermane Federale, Dhjetor 2020

Sipas Bankës Federale Gjermane, investitorët gjermanë investuan në rajonin e EJL-së 29.8 miliardë EUR gjatë vitit 2018, të cilat përbënin 4.7% të investimeve të jashtme të Gjermanisë në rajonin Evropian. Këto investime shfaqën një rritje vjetore me 2.8% nga 2017 (29.0 miliardë EUR).


Investimet në rajone të tjera evropiane u vlerësuan 605.2 miliardë EUR në 2018 duke shfaqur një rritje prej 3.6% nga 2017 (584.0 miliardë EUR). IHD-të e jashtme gjermane në EJL u rritën me një normë vjetore CAGR prej 3.5% gjatë 2015-2018 dhe investimet e bëra në rajone të tjera evropiane u rritën me një normë vjetore mesatare CAGR prej 7.3% në të njëjtën periudhë kohore.

Gjermani - Përbërja e fondeve të IHD-ve dalëse në EJL 2018



Burimi: Banka Federale Gjermane, Dhjetor 2020  
Shënim \* - Mungojnë informacionet për IHD-të gjermane në Malin e Zi

Gjermani - Përbërja e fondeve të IHD-ve dalëse në EJL 2015



Burimi: Banka Federale Gjermane, Dhjetor 2020  
Shënim \* - Mungojnë informacionet për IHD-të gjermane në Malin e Zi


Sipas Bankës Federale Gjermane, Rumania përbënte nivelin më të lartë të fondeve të jashtme gjermane të IHD-ve në rajonin e EJL në 2018 c. 10.2 miliardë EUR, duke shfaqur një rritje prej 8.8% nga 2017 (9.4 miliardë EUR).

Turqia zuri pjesën e dytë më të madhe të këtij grupi të fondeve gjermane të jashtme gjatë vitit 2018 me 8.7 miliardë EUR, duke shfaqur një rënie me 7.1% krahasuar me vitin e mëparshëm (9.4 miliardë EUR). Në lidhje me kapitalin në rajonin e EJL-së, fondet gjermane në Turqi ranë proporcionalisht nga 2015 (35.2%) në 2018 (29.2%) me 6 pikë %, në avantazh të kapitalit gjerman në Rumani, i cili u rrit me 3.7 pikë % nga 2015 (30.7%) deri në vitin 2018 (34.4%).

Ndërsa për sa u përket vendeve të Ballkanit Perëndimor, Serbia kishte një rritje të lehtë me 1.4% të pjesëmarrjes së IHD-ve gjermane në EJL nga 2015 (4.8%) në 2018 (6.4%). Kroacia tërhoqi 9.8% të stokut të IHD-ve të jashtme gjermane në SEE duke shfaqur një rritje me 2.5% nga 2017 (2.85 miliardë euro) në 2018 (2.92 miliardë euro).

Gjatë 2015-2018, stoku gjerman në rajonin e EJL u rrit me një normë vjetore mesatare të rritjes CAGR prej 3.5%. Moldavia kishte rritjen vjetore më të lartë me 32.1% nga 2015 (92.0 miliardë euro) në 2018 (212.0 miliardë euro). Maqedonia e Veriut kishte rritjen e dytë më të lartë në rajon për sa i përket normës vjetore të rritjes me 22.4% gjatë së njëjtës periudhë kohore. I vetmi vend në rajonin e EJL, ku fondet e IHD-ve gjermane u zvogëluan gjatë 2015-2018 ishte Turqia me 2.8%.


Siç mund të vërehet nga seksionet e mësipërme, kontributi i fondeve të kapitalit gjerman është përqendruar në shtetet anëtare të BE-së me më pak barriera si Rumania dhe Kroacia.



Bazuar në informacionin e siguruar nga DB, sektori ku investitorët gjermanë përgjithësisht investuan më shumë gjatë periudhës 2015-2018 ishin aktivitetet e shërbimit financiar. Gjatë vitit 2018, aktivitetet e shërbimit financiar përbënin 53.0% të investimeve të jashtme gjermane, të ndjekura nga segmenti i prodhimit me një pjesëmarrje prej 24.6%. Aktivitetet e shërbimit financiar përfshinin kompani aksionere (holding) pa funksione menaxhimi, përveç fondeve të sigurimeve dhe të pensioneve. Aktiviteti prodhues përfshinte investimet e huaja në prodhimin e produkteve kimike, pajisjeve elektrike, makinerive, automjeteve motorike, rimorkiove dhe gjysmë rimorkiove. Riparimet e automjeteve dhe motoçikletave ishin të përfshirë në industrinë e tregtisë me shumicë dhe pakicë. Investimet në aktivitetet e zyrave qendrore përfshinin shoqëritë aksionere (holding) me funksion menaxhimi.


### Rezultatet e pyetësorit

Sipas të dhënave të sondazhit, tregohet se numri më i lartë i investitorëve gjermanë në Kosovë kanë kombësi gjermane (71%). Gjithashtu, u etiketua se shumica e të anketuarve me kombësi gjermane operojnë në industrinë e shërbimeve (50%), ndërsa të anketuarit e kombësisë kosovare kryesisht operojnë në industrinë e prodhimit dhe ndërtimit (67%).



Lidhur me perceptimet e veprimtarisë së biznesit në të ardhmen, nga të dhënat e sondazhit është zbuluar se 61% e të anketuarve, etiketuan një periudhë të pacaktuar planifikimi për investime të vazhdueshme, rritje dhe zgjerim të aktiviteteve.

## INVESTIMET E HUAJA DIREKTE NË EVROPËN JUGLINDORE



Burimi: Banka Botërore, Banka Qendrore e Kosovës, Dhjetor 2020

Sipas Bankës Botërore, vendet e vetme të EJL-së ku IHD-të u rritën ndjeshëm në 2019 për sa i përket rritjes vjetore ishin Moldavia (100.3%), Bullgaria (29.6%) dhe Sllovenia (17.1%). Vendet e Ballkanit Perëndimor gjatë vitit 2019 përgjithësisht tërhoqën më pak investime të huaja sesa në vitin 2018. Rënia më e ndjeshme e IHD-ve u shfaq në Bosnjë dhe Hercegovinë me 30.9%, e ndjekur nga Turqia (38.9%) dhe Maqedonia e Veriut (22.5%).


Turqia, Rumania dhe Serbia ishin vendet e EJL-së me nivelin më të lartë të IHD-ve gjatë vitit 2019. Investimet e huaja në Turqi regjistruan 7.8 miliardë EUR dhe përbënin 31.6% të fondeve të jashtme gjermane në rajon. Investimet në Rumani kishin vlerë 6.2 miliardë EUR dhe përbënin 24.9% të investimeve të jashtme gjermane. Kosova tërhoqi 1.0% të IHD-ve të rajonit në 2019, duke arritur në 0.3 miliardë EUR.

Në terma relativë, shkalla më e lartë e depërtimit në vitin 2019 (IHD / PBB%) u regjistrua në Mal të Zi, Serbi dhe Shqipëri, përkatësisht me 8.4%, 8.3% dhe 7.9%, ndërsa depërtimi në Kosovë është 3.6% më i ulët krahasuar me vendet fqinje (Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia).

Në përputhje me analizën e mësipërme, tabela më poshtë synon të paraqesë trendin historik të shkallës së depërtimit për periudhën 2015 dhe 2019.



EJL - Shkalla e depërtimit (IHD/PBB)




Burimi: Banka Botërore, Dhjetor 2020

Siç mund të vërehet nga tabela, ndonëse për shumicën e vendeve shkalla e depërtimit ka mbetur pothuajse e qëndrueshme, duke treguar një trend linear rritjës për IHD-të dhe PBB-në, vendet si Mali i Zi, Kosova, Serbia dhe Bullgaria ndryshojnë.

Mali i Zi përjetoi uljen më të lartë, nga 17.3% në 8.4% të shkaktuar nga një rënie e madhe e IHD-ve (10%). Një trend i njëjtë u ndoq nga Kosova, me ulje të shkallës së depërtimit, të shkaktuar nga një tkurrje me 15% të IHD-ve (2019/2015), ndërkohë që PBB-ja u rrit me 5%.

# IHD-TË E PARASHIKUARA NË EVROPËN JUGLINDORE

## Parashikimi i IHD-ve në EJT




Burimi: Economist Intelligence Unit (EIU), Emis, Dhjetor 2020 Shënim \*: Mediana e EJT-së llogaritet bazuar në parashikimet për tetë vende të rajonit  
Shënim \*: Asnjë informacion për Malin e Zi, Bosnjë dhe Hercegovinën, Moldavinë dhe Maqedoninë e Veriut

Sipas EIU dhe EMIS, IHD-të në Kosovë janë projektuar të arrijnë 0.31 miliardë EUR gjatë vitit 2020, duke u rritur me një normë të përlogaritur prej 22.5% krahasuar me fundin e vitit 2019 (0.25 miliardë EUR). Të gjitha vendet e tjera të rajonit pritet të regjistrojnë një rënie të IHD-ve gjatë vitit 2020. Bullgaria parashikohet të tërheqë 0,5 miliardë euro IHD-sh gjatë vitit 2020 duke përjetuar kështu dhe uljen më të lartë në rajon, me 66.5%. Rajoni i EJT-së në total parashikohet të tërheqë IHD me vlerë 14.1 miliardë EUR, duke shfaqur një rënie prej 39.0% nga 2019 (23.1 miliard EUR). Sipas Institutit të Vjenës për Studime Ekonomike Ndërkombëtare, rënia pritet të vijë për shkak të çrregullimeve ekonomike të shkaktuara nga pandemia Covid-19.

Gjatë viteve 2020-2023, Kosova parashikohet të regjistrojë një normë të rritjes vjetore CAGR prej 4.7%. Për sa i përket ritmeve të rritjes së IHD-ve, midis vendeve të EJT-së, Bullgaria, Rumania dhe Turqia priten të regjistrojnë vlerat më të larta, përkatësisht 61.3%, 57.7% dhe 48.5%. Sllovenia është i vetmi vend në rajon i cili parashikohet të regjistrojë një rënie me një CAGR prej 9.9%. Krahasuar me vendet e Ballkanit Perëndimor, për sa i përket IHD-ve, Kosova pritet të regjistrojë një rritje vjetore mesatare më të lartë sesa Serbia (2.4%), por më të ulët se Shqipëria (8.1%) dhe Kroacia (14.5%).

Sipas EIU, rajoni i EJT-së pritet të tërheqë më shumë investime të huaja gjatë 2020-2023 duke arritur një normë mesatare të rritjes CAGR prej 34.2%.

## INVESTIMET E HUAJA DIREKTE NË KOSOVË




Sipas Bankës Qendrore të Kosovës, gjatë vitit 2019, niveli i përgjithshëm i investimeve të huaja direkte në Kosovë arriti në 254.6 milion EUR, duke shfaqur një rënie prej 6.4% krahasuar me 2018 (271.2 mln EUR). IHD-të e Kosovës u ulën me një normë vjetore mesatare CAGR prej 4.7% gjatë 2015-2019. Sektori më i preferuar për investitorët e huaj ishte ai i pasurive të paluajtshme me vlerë 233.4 milion EUR. Ky sektor shfaq rritjen më të lartë gjatë periudhës 2015-2019 për sa i përket normës vjetore mesatare CAGR prej 5.3%. Ky grup përbënte 91.7% të IHD-ve totale dhe regjistroi një rritje vjetore prej 12.5% krahasuar me 2018 (207.5 milion EUR). Pjesa e dytë më e madhe e IHD-ve të Kosovës përbëhej nga sektori i Industrisë me c. 5.6% e IHD-ve totale në vitin 2019. Vlerat negative të ndërtimit gjatë vitit 2018 dhe industrisë gjatë vitit 2019 janë pasojë e disinvestimeve në këta sektorë.

Në vitin 2020 (Janar-Korrik), IHD-të në Kosovë u rritën me një normë prej 37.1% krahasuar me të njëjtën periudhë në vitin 2019. Pasuritë e Paluajtshme mbetën sektori kryesor i investimeve nga investitorët e huaj, por niveli i investimeve pësoi rënie krahasuar me të njëjtën periudhë në 2019. Kjo lidhet gjithashtu me impaktin e COVID-19, i cili mund të ketë ngadalësuar investimet jo vetëm në BE por në të gjithë botën.

### Rezultatet e pyetësorit


Sipas rezultateve të sondazhit, 29% e të anketuarve operojnë në sektorin e Prodhimit dhe ndërtimit (ju lutemi gjeni përbërjen e detajuar sektoriale në shtojcën 5 të këtij raporti), ndjekur nga sektori i Shërbimeve me 26%.

#### Sektori i Operimit




U zbulua gjithashtu nëpërmjet sondazhit se 42% e kompanive të anketuara kishin 1-4 vjet aktivitet operativ në Kosovë, kryesisht të përqendruar në investime në sektorin e Shërbimeve. Ndërkohë, 35% kishin 5-10 vjet veprimtari aktive, kryesisht në sektorin e prodhimit dhe ndërtimit.

Pjesa e mbetur 23% kishin më shumë se 10 vjet aktivitet operativ në Kosovë të përqendruar në sektorin e shërbimeve financiare, bankare dhe konsultimit.



Burimi: Analizë e Sondazhit


Sipas BQK-së, fondet e investimeve të kapitalit kanë qenë historikisht burimet kryesore të financimit për IHD-të në Kosovë, duke kontribuar mesatarisht 87.7% të totalit të investimeve të huaja gjatë 2015-2019. Në të njëjtën periudhë kohore, këto lloj investimesh janë rritur me një normë vjetore mesatare të rritjes CAGR prej 6.1%. Megjithatë, gjatë shtatë muajve të parë të vitit 2020, financimi i investimeve përmes fondeve investuese të kapitalit vetjak u ul në 79.6% si pasojë e Covid-19. Nga ana tjetër, instrumentet e borxhit janë ulur me një normë vjetore mesatare CAGR prej 29.6% gjatë të njëjtës periudhë duke rezultuar në një rënie të kontributit të tyre në IHD-të totale në Kosovë nga 26.2% në 2015 në 6.4% në 2019.



Burimi: Banka Qendrore e Kosovës (BQK), Dhjetor 2020

Sipas Bankës Qendrore të Kosovës, investimet e huaja nga Gjermania ishin kontribuesit kryesorë të IHD-ve të Kosovës gjatë vitit 2019 duke u rritur me 16.4% në krahasim me 2018 (60.2 milion EUR). IHD-të nga Zvicra, i dyti për nga madhësia në 2019 me 61.9 mln EURO, u ulën me 12.8% krahasuar me 2018 (71 milion EUR). IHD-të nga Gjermania janë rritur ndër vite (2015-2019) me 11.6% (norma vjetore e rritjes), duke e bërë të vetmin trend pozitiv i rritjes larg vendeve të tjera kontribuese.


## Kosovë - Përbërja e IHD-ve sipas vendeve (mln EUR)



Burimi: Banka Qendrore e Kosovës (BQK), Dhjetor 2020

## IHD-TË DHE "TË BËRIT BIZNES"

### IHD dhe Renditja e të Bërit Biznes



Burimi: Banka Botërore, Banka e Kosovës, Dhjetor 2020  
Shënim \*: 0-190 nga niveli më i lartë të më i ulët

Ky seksion ka si synim përcaktimin e korrelacionit midis Investimeve të Huaja Direkte dhe renditjes nga raporti i Të Bërit Biznes, pavarësisht nga çdo faktor tjetër që mund të ndikojë në nivelin e IHD-ve. Vendet e reja ose ato në zhvillim si Kosova, me një reputacion ose njohje relativisht të ulët, varen nga raportet ndërkombëtare për të tërhequr investitorë të huaj. Raporti i Bankës Botërore i Të Bërit Biznes

jep një prezantim të vendit, përfitimeve dhe pengesave të tij dhe shpesh është një përcaktues për investitorët kur zgjedhin një vend. Sa më e ulët rezultati në raport, aq më lehtë është bërja biznes në një vend specifik.

Sipas publikimeve të Doing Business, në vitin 2020 Kosova u rendit e 57-ta nga e 190-ta në lidhje me lehtësinë e të bërit biznes, 13 pozicione më poshtë nga raporti i Të Bërit Biznes i 2019 (e 44-ta). Bazuar në këto raporte të Bankës Botërore, Kosova arriti rezultatin më të ulët të vlerësimit në 2011, duke u renditur në vendin e 119-të. Kosova ka bërë përmirësime në klimën e biznesit duke filluar nga 2012 dhe në 2018 kishte renditjen më të mirë (e 40-ta) që kur Banka Botërore filloi të publikonte raportin e Të Bërit Biznes në 2003.

Luhatjet më të rëndësishme në IHD-të e Kosovës shënohen gjatë viteve 2012 dhe 2014. Në vitin 2011, kriza e Kosovës së Veriut, bëri që të rriteshin tensionet e mëtejshme në rajon. Ndërkohë në të njëjtën periudhë, kriza evropiane u përfshi nga kriza e borxhit. Të dy këta faktorë çuan në një rënie të IHD-ve. Si rrjedhojë, teksa tensioni ishte akoma i lartë në rajon, lehtësia e të bërit biznes deri në vitet 2012 u ul, dhe Kosova u ngjiti në renditje. Mund të supozohet se një përkeqësim në këto renditje i dekurajon investitorët. Ndërsa renditjet u ulën në 2012 dhe 2013, konflikti gjeopolitik u lehtësua disi, situata politike u përmirësua dhe zgjedhjet që ndodhën ishin transparente, duke çuar në rritjen e IHD-ve në 2013.

Në raportin e Të Bërit Biznes në 2013, Kosova u rendit e 100-ta nga 185 vende. Kosova forcoi mbrojtjen e investitorëve të pakicave duke dhënë më shumë informacion shpjegues në lidhje me transaksionet me palët e interesuara, duke zgjeruar qasjen në informacionin e korporatave para gjykimit, duke qartësuar pronësinë dhe strukturat e kontrollit dhe duke kërkuar transparencë më të madhe të korporatave. Këto përmirësime ndikuan pozitivisht në sasinë e IHD-ve në vitet në vijim.

Në vitin 2014, norma e inflacionit ra në 0.6%, më pak se norma prej 1.8% gjatë së njëjtës periudhë në vitin 2013. Kjo rënie i atribuohet uljes së çmimit të mallrave të importuara, e cila reflekton ndërlidhjen ndërmjet zhvillimeve të çmimeve në Kosovë dhe çmimeve në tregjet ndërkombëtare. Rritja e kërkesës së brendshme në vitin 2014 pati një ndikim në rritjen e importit dhe në rritjen e deficitit të llogarisë rrjedhëse. Sipas raportit të Të Bërit Biznes në 2015, i cili i referohet periudhës Qershor 2013-Qershor 2014, Kosova u rendit e 62-ta në treguesin e mbrojtjes së investitorëve. Ndërsa IHD-të arritën nivelet e tyre më të ulta në vitin 2014, lehtësia e të bërit biznes vazhdoi të përmirësohej. Mungesa e korrelacionit atë vit nuk lidhet me Kosovën, pasi IHD-të ranë edhe në disa nga vendet e tjera të rajonit të EJT-së.

Gjatë periudhës 2015-2018, u shfaq një korrelacion pozitiv midis IHD-ve dhe renditjes së Të Bërit Biznes. Ndërsa shteti i ri Ballkanik vazhdoi të rritej dhe të ecte përpara në rrugën e integritit evropian, IHD-të u rritën dhe lehtësia e të bërit biznes u përmirësua. Në vitin 2016, u nënshkrua Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit BE-Kosovë, duke shërbyer si një mjet i dobishëm për të drejtuar zbatimin e reformave të lidhura me BE-në në Kosovë. Në korrik 2018, sipas Raportit të Komisionit të BE 2019, Komisioni konfirmoi se Kosova kishte përmbushur të gjitha standardet e liberalizimit të vizave dhe vitin e ardhshëm Parlamenti Evropian mbështeti propozimin e Komisionit. Kosova bëri përparim në lidhje me sundimin e ligjit dhe administratën publike, edhe pse është akoma në fazat e para të reformave të sistemit gjyqësor, luftës kundër korrupsionit dhe krimeve të organizuara. Nga ana tjetër, gjatë kësaj periudhe, Kosova përparoi shumë në garantimin e të drejtave të njeriut, lirinë e fjalës dhe zhvillimin e një ekonomie funksionale të tregut. Të gjitha këto përmirësime çuan në renditje më të mirë në raportin e njohur të Të Bërit Biznes, gjë që u përkthye në IHD më të larta.

Rritja e lehtë në Raportet e Bërjes së Biznesit të 2019 dhe 2020, i referohej kthimit të tensioneve me Serbinë, tarifave të vendosura dhe paqëndrueshmërisë politike me disa parti që nuk ishin në gjendje të formonin qeveri të qëndrueshme. Duke konfirmuar korrelacionin pozitiv midis dy variablave, IHD-të ranë në të dy periudhat.



## **IMPAKTI SOCIAL I IHD-VE**

Hyrjet e IHD-ve zakonisht ofrojnë përfitime ekonomike të tilla si rritja e konkurrencës, rrjedhjet (transferimet) teknologjike dhe inovacionet. Megjithatë, ndikimi i investimeve të huaja shtrihet përtej rritjes ekonomike. Ndonjëherë IHD-të mund të shërbejnë si një katalizator për ndryshimin e shoqërisë si një e tërë, prandaj impakti që lë ëshë i një rëndësie të madhe (faktorët ekonomikë, politikë, socialë, teknologjikë, kulturorë dhe mjedisorë.)

### **Efektet dhe rrjedhet (transferimet) teknologjike**

Një avantazh i IHD-ve është mundësia e transferimit të teknologjisë, e cila mund të mundësojë që vendi marrës të përfitojë nga teknologjitë e përparuara të zhvilluara jashtë vendit. Transferimet mund të jenë rezultat i presioneve konkurruese (Globerman, 1979; Blomstrom, 1986), efektet demonstruese, lëvizshmëria e stafit të trajnuar nga bizneset me pronësi të huaj në ato me pronësi vendase ose bashkëpunimi me furnizuesit vendas për të përmirësuar produktet e tyre (Caves, 1998; Nayak, 2005).

Për sa i përket efektit indirekt, Sjöholm (2008) gjeti një lidhje të qartë midis punësimit dhe teknologjisë. Nga njëra anë, teknologjia e re mund t'i bëjë firmat më konkurrenente duke i lejuar ato të rriten dhe të punësojnë më shumë punonjës. Nga ana tjetër, teknologjia e re mund të ulë kërkesën për punë duke zëvendësuar punonjësit më pak të kualifikuar me një numër më të ulët punonjësish të kualifikuar. Prandaj, ndryshimi i politikave të teknologjisë do të ndikojë në krijimin e vendeve të punës.

### **Efektet në punësim**

#### **Efektet direkte vs indirekte**

IHD-të kanë potencial për të gjeneruar punësim përmes punësimit të drejtpërdrejtë të njerëzve për impiantet e reja, që do të thotë se ato përmirësojnë punësimin e përgjithshëm të brendshëm përmes llojeve të vendeve të punës të krijuara, shpërndarjes rajonale të punësimit të ri, niveleve të pagave, shpërndarjes së të ardhurave dhe transferimit të aftësive (Mickiewicz, Radosevic dhe Varblane (2000)). Këto efekte të drejtpërdrejta shoqërohen me efekte indirekte ose transferuese.

Efektet indirekte ndodhin përmes lëvizjes së fuqisë punëtore të trajnuar nga firma të huaja në sektorë të tjerë, duke qenë se ato krijojnë lidhje me furnizuesit dhe ofruesit e shërbimeve, si dhe përmes rritjes së të ardhurave, të cilat gjithashtu mund të rrisin punësimin përmes niveleve më të larta të konsumit, kursimeve dhe investimeve.

Integrimi i IHD-ve në një ekonomi lokale rezultojnë në transmetimin e kulturës së biznesit, e cila përfshin vlerat e korporatave, strukturat organizative dhe praktikatat e menaxhimit (Mirza, 1998). Për shkak se IHD sjellin teknologji relativisht të re, ndikimi i saj në punësim varet nga ndërveprimi midis rritjes së produktivitetit, rritjes së prodhimit dhe specializimit të fuqisë punëtore. Së bashku me përmirësimin e aftësive, teknologjisë, produktivitetit dhe tregtisë, IHD-të mund të kenë efektet e mundshme të pafavorshme në pagat dhe punësimin në ekonominë pritëse.

<b>Matrica e punësimit</b>	<b>Direkt</b>		<b>Indirekt</b>	
	<b>Pozitiv</b>	<b>Negativ</b>	<b>Pozitiv</b>	<b>Negativ</b>
<b>Sasia</b>	Shton kapitalin neto dhe krijon vende pune në industrinë e zgjerim	Blerjet mund të rezultojnë në racionalizim dhe humbje të vendeve të punës	Krijimi i vendeve të punës përmes lidhjeve të ndërsjellta (para dhe	Mbështetja në importe ose zhvendosje të firmave ekzistuese rezultojnë në

		prapavepruese) të investimeve dhe efekteve shumëfishuese në ekonominë lokale	humbje të vendeve punës
<b>Cilësia</b>	Paguan paga më të larta dhe ka produktivitet më të lartë	Prezanton praktika si p.sh. punësimi dhe ngritja në detyrë që konsiderohen të padëshirueshme	Transferimi i aftësive në lidhje me organizimin e punës sipas "praktikave më të mira" për firmat vendase
<b>Vendndodhja</b>	Shton vende të reja pune në zona me papunësi të lartë	Turmat tashmë kanë mbingarkuar zonat urbane dhe kanë hequr çekuilibrat rajonalë	Inkurajon migrimin e ofertës për punë në zonat me disponibilitet të fuqisë punëtore
			Krijon disavantazh për prodhuesit vendorë, duke shtuar papunësinë në rajon, nëse filialet e huaja zëvendësojnë prodhimin vendas ose mbështeten në importe

Burimi: Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Tregtinë dhe Zhvillimin (UNCTAD), 1999

Ndërsa ndikimi i drejtpërdrejtë i IHD-ve në punësim nuk ka një përgjigje përfundimtare, IHD-të mund të krijojnë ndikim indirekt pozitiv në gjenerimin e punësimit. Sidoqoftë, hulumtimi mbi efektin indirekt të IHD-ve në punësim është shumë i kufizuar. Vlerësimet e ndikimit të IHD-ve në Sh.B.A nga Glickman dhe Woodward (1989) duke përdorur të dhënat e sondazhit nga Byroja e Analizës Ekonomike (BEA) kanë treguar një rritje thelbësore të punësimit midis 1982 dhe 1986.

### Mënyra e konsiderimit të hyrjes

Shumica e studiuësve konkludojnë se investimi do të kishte efekte më të larta pozitive të punësimit nëse merr formën e investimit "Greenfield". Investimet "Greenfield" përfshijnë krijimin e impianteve të reja prodhuese, pasi ato krijojnë kapacitete të reja prodhuese dhe rrisin kërkesën për punë. Përndryshe, ato potencialisht mund të sjellin teknologji të kursimit të punës të cilat zvogëlojnë kërkesën për punë si dhe përjashtojnë firmat e vendit më pak konkurruese duke rezultuar në një efekt neto negativ. Nga ana tjetër, pritjet të jetë i kufizuar, madje negativ efekti në nivelin e punësimit nëse kapitali i huaj vjen përmes bashkimeve dhe blerjeve duke blerë ndërmarrjet e privatizuara (Dicken, 2007).

Mickiewicz, Radosevic dhe Varblane (2000) treguan se sa më e madhe larmia e llojeve të IHD-ve, aq më e favorshme për ekonominë pritëse. Ekziston një potencial më i lartë që kjo do të çojë në lloje më të larmishme të rrjedhjeve dhe transferimeve të aftësive. Nëse politika nuk është në gjendje të maksimizojë shkallën e hyrjeve të IHD-ve, politikëbërësit duhet të përqendrohen më shumë në tërheqjen e llojeve të ndryshme të IHD-ve.

### Konsideratat përfundimtare

Së fundmi, mund të konkludojmë se kuantifikimi i ndikimit të përgjithshëm të IHD-ve në punësim është ende e pasigurt si nga pikëpamja teorike ashtu edhe nga ajo empirike. Në masën që IHD-të kontribuojnë në rritjen ekonomike, ato kontribuojnë indirekt dhe në krijimin dhe përmirësimin e punësimit.

## **Raste studimore: Vështrim i investimeve me ndikim social në Kosovë**

Më poshtë janë paraqitur disa shembuj të investimeve dhe projekteve të cilat kanë shfaqur dëshmi të ndikimit social të investimeve në Kosovë siç janë punësimi, aftësitë, përparësitë teknologjike ose tregues të tjerë social.

### **1. Rinia, Punësimi dhe Aftësitë në Kosovë**

**Historiku:** Ky projekt është zhvilluar nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunimin dhe Zhvillimin Ekonomik (BMZ) gjatë 2017-2020.

**Çështja Sociale:** Niveli i lartë i papunësisë së të rinjve (më shumë se 50%) dhe norma e lartë e vendeve të lira të punës në sektorin privat dhe nevoja për të punësuar staf. Projekti synonte të lidhte aftësitë e punëkërkuësve me kërkesat e tregut të punës e cila është një sfidë e madhe në Kosovë.

**Ndikimi:** Projekti Rinia, Punësimi dhe Aftësitë në Kosovë rriti mundësinë e punësimit të të rinjve duke përmirësuar cilësinë e arsimit dhe aftësimin profesional dhe gjithashtu duke forcuar mekanizmat e përputhjes midis ofertës dhe kërkesës së tregut të punës. Deri në fund të vitit 2018, rreth 3,000 të rinj në Kosovë kishin përfituar drejtpërdrejt nga një gamë e gjerë e zhvillimit të kapaciteteve njerëzore dhe masave të ndërmarra në tregun të punës. Projekti synonte:

- Të ofronte skema praktike për mbi 2,000 punëkërkuës të rinj në Kosovë. Për më tepër, mbi 600 ide të reja biznesi u mbështetën financiarisht.
- Përmirësimin e cilësisë së arsimit profesional - është investuar në 10 shkolla teknike dhe ekonomike të cilat janë përqendruar në zbatimin e planeve të zhvillimit të shkollës, rritjen e mundësive të trajnimit të bazuara në vendin e punës dhe forcimin e kompetencave të mësuesve të praktikës profesionale.
- Të bëjë të mundur plotësimin e nevojave dhe kërkesave të sektorit privat për punë të kualifikuar, posaçërisht për IT, dizajn grafik, gastronomi, rrobaqepësi, artizanat, ndërtim metali dhe aftësi të buta.

### **2. Furnizimi me ujë dhe shkarkimi i ujërave të ndotura**

**Historiku:** Ky projekt u realizua në Prishtinë në emër të Qeverisë Federale Gjermane. Një investim total prej 50 milion EUR u financua nga Qeveria Federale Gjermane dhe BE, ndërsa 10 milion EUR u financuan nga qeveria.

**Çështja sociale:** Humbjet e ujit dhe Infrastruktura e dobët ekzistuese

**Ndikimi:** Disa nga rezultatet kryesore janë:

- Janë instaluar gjithsej 18,000 lidhje të reja shtëpiake dhe ujëmatës.
- Masat kontribuan në sigurimin e një furnizimi të vazhdueshëm dhe higjienik të ujit të pijshëm për Prishtinën dhe zonën përreth në dekadat e ardhshme – edhe përgjatë muajve të verës. Projekti synonte të arrinte një furnizim të pandërprerë me ujë prej 23 orësh në ditë. Ndërtimi i një stacioni pompimi do të thoshte që 6,000 banorë që jetojnë në rrethin më të lartë të rajonit të Kodrës mund të furnizoheshin me ujë me besueshmëri. Në total, kompania e furnizimit me ujë rriti numrin e klientëve të saj me 15%.
- Përdorimi i infrastrukturës së re përmirëson furnizimin me ujë të pijshëm për banorët lokalë, parandalon përdorimin e mëtejshëm të rezervuarëve të Batllava dhe Badovc dhe inkurajon mbrojtjen e burimeve ujore. Në të njëjtën kohë, më shumë njerëz ishin të lidhur me furnizimin publik të ujit të pijshëm.

### **3. Fabrika e Ferronikelit**

**Historiku:** Cunico Resources N.V (Cunico) është një kompani ndërkombëtare minerare e angazhuar në kërkimin, shfrytëzimin, përpunimin, tregtimin dhe shitjen e nikelit, bakrit dhe kobaltit. Fabrika e Ferronikel është investimi më i madh privat në industrinë e rëndë në Kosovë. Deri më tani janë investuar 60 milion euro dhe pritet të regjistrohen investime të mëtejshme. Më 31 Dhjetor 2006, operacionet e Kompanisë prodhuan 10,942 ton nikel.

**Ndikimi:** Kompania ka 1,018 punonjës dhe 300 punonjës të tjerë përmes nënkontraktuesve. Ferronikel kontribuon me 50% të eksportit të përgjithshëm të Kosovës. Produktet e tyre eksportohen sidomos në Gjermani, Itali, Spanjë, Indi etj.

### **4. Aeroporti Adem Jashari**

**Sfondi:** Aeroporti Ndërkombëtar Limak Kosovo Sh.a. përfundoi ndërtimin dhe vuri në shërbim ndërtesën e re të terminalit dhe objektet e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës Adem Jashari me një ceremoni në 23 tetor 2013. Ndërtesa e re e terminalit dhe objektet u projektuan dhe ndërtuan me një koncept

arkitektonik modern, duke reflektuar teknologji të avancuara, të përshtatura me nevojat e pasagjerëve dhe kërkesave të ruajtjes së një ambjenti ekologjik. Limak ka një kontratë 20 vjeçare me qeverinë për përdorimin e aeroportit. I gjithë projekti u vlerësua mbi 140 milion euro.

**Ndikimi:** Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës Adem Jashari është aeroporti i vetëm ndërkombëtar në Kosovë dhe porti i vetëm i hyrjes për udhëtarët civilë ajrorë në vend.

Hapja e terminalit të ri pritet të sjellë një rritje të kapacitetit vjetor të pasagjerëve të aeroportit nga 2 në 5 milion. Aeroporti tashmë është renditur i treti në numrin e pasagjerëve vjetorë midis aeroporteve në vendet e ish-Jugosllavisë, pas aeroporteve të Beogradit dhe Zagrebit. Ndikime të tjera shihen në turizëm, zhvillimin e biznesit lokal, struktura akomoduese etj.

## 5. Projekti i ardhshëm: ScandGreen Energy

**Sfondi:** ScandGreen Energy është një kompani norvegjeze me më shumë se 30 vjet përvojë në prodhimin e kimikateve dhe ka fabrika në vende të ndryshme si Sllovakia, Danimarka dhe Gjermania. ScandGreen Energy pritet të investojë rreth 65 milion EUR në Kosovë për të ndërtuar një termocentral për riciklimin e mbeturinave.

**Ndikimi i prituri:** Riciklimi i mbeturinave është një nga sektorët që ka potencial të madh por me më pak zhvillim në Kosovë. Qeveria është e interesuar të zhvillojë më shumë këtë sektor dhe ka hyre në diskutime me ScandGreen Energy. Projekti do të kontribuojë në rritjen e punësimit, përmirësimin e mjedisit dhe cilësinë e jetës.

## 6. Kivo

**Historiku:** Kompania Hollandeze Kivo, ndodhet në komunën e Kaçanikut që nga viti 2015. Kjo kompani është një nga prodhuesit më të mëdhenj të paketimeve plastike në Evropë.

**Ndikimi:** Në Kosovë, ndërmarrja ka 130 të punësuar. Sipas investitorit Robert Kwakman, ajo që e tërhoqi atë për të investuar në Kosovë ishte fuqia e lirë punëtore. Por për të Kosova ofron shumë mundësi të tjera për një investitor të huaj. Investime të ngjashme përmirësojnë bilancin tregtar duke zvogëluar varësinë nga importi i produkteve plastike për paketim dhe gjithashtu përbëjnë avantazh konkurrues në eksporte, duke marrë parasysh përfitimet nga kostot e ulëta të fuqisë punëtore dhe kostove të tjera.

## 7. Energjia

**Historiku:** Sektori i energjisë në Kosovë po përballlet me sfida të konsiderueshme në lidhje me objektet e vjetruara dhe mirëmbajtjen jo të përshtatshme. Kërkesa në rritje e vendit për energji elektrike nuk është përmbushur siç duhet deri më tani, duke rezultuar në pakënaqësi të konsiderueshme midis konsumatorëve.

**Ndikimi:** Që nga viti 1999, Qeveria Federale Gjermane ka angazhuar fonde në total më shumë se 163 milion EUR për sektorin e energjisë, kryesisht për të zgjeruar pajisjet e transmetimit të energjisë dhe ngrahjen qendrore, por edhe për të krijuar një "atlas" të erës. Kjo e bën më të lehtë për investitorët të vlerësojnë kthimet e mundshme nga investimet në projektet e energjisë së erës.

# **LEGJISLACIONI FIKSAL NË KOSOVË**

**[Shënim i Seksionit: Analiza do të përfshijë ndikim hipotetik në buxhetin fiskal të vendit nga tatimi i korporatave, TVSH-ja, kontributi social etj. Më poshtë ligjet tatimore dhe regjimet janë përshkruar në detaje, të cilat do të shërbejnë si referencë për gjetjet e studimit.]**

## **Tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH)**

TVSH-ja do të ngarkohet në përputhje me dispozitat e ligjit, për:

- Furnizimin me mallra dhe shërbime brenda territorit të Kosovës nga një person i tatueshëm;
- Importimi i mallrave në Kosovë.

Ku person i tatueshëm është çdo person i cili është ose kërkohet të regjistrohet për TVSH dhe i cili në mënyrë të pavarur kryen aktivitet ekonomik në një mënyrë të rregullt ose jo të rregullt, pavarësisht qëllimit ose rezultatit të asaj veprimtarie ekonomike.

Organet e organizatave ndërkombëtare, vendet e huaja dhe agjencitë e tyre nuk do të konsiderohen si persona të tatueshëm në lidhje me aktivitetet ose transaksionet e ngjashme ose identike me ato më sipër, edhe nëse ata marrin pagesa në lidhje me ato aktivitete. Sidoqoftë, agjencitë e vendeve të huaja do të konsiderohen si persona të tatueshëm në lidhje me ato aktivitete ose transaksione kur trajtimi i tyre në vendin e tyre do të rezultojë në konsiderimin e atyre aktiviteteve si të kryera nga një person i tatueshëm.

Çdo person i cili plotëson të gjitha kushtet e përkufizimit për personin e tatueshëm kërkohet të regjistrohet për TVSH nëse tejkalon qarkullimin prej tridhjetë mijë (30,000) euro brenda një viti kalendarik. Vetëm pjesa e furnizimit që rezulton në tejkalimin e xhiros do të merret parasysh për qëllime të TVSH-së. Personat e huaj që zhvillojnë një aktivitet ekonomik në Kosovë do të konsiderohen persona të tatueshëm që nga fillimi i ushtrimit të një aktiviteti ekonomik në Kosovë. Njësia e përhershme e personit jo-rezident është personi i tatueshëm që nga fillimi i aktivitetit ekonomik në Kosovë.

Çdo person, përveç nëse parashikohet ndryshe në ligjin e TVSH-së, është i detyruar të regjistrohet me arritjen e qarkullimit të përmendur më lart (30,000 euro) dhe do të njoftojë autoritetet brenda 15 ditëve kalendarike nga momenti i lindjes së detyrimit për regjistrim. Regjistrimi hyn në fuqi në datën kur tejkalohej qarkullimi. Sidoqoftë, ata kanë të drejtë të zgjedhin të regjistrohen dhe të njoftojnë autoritetet në përputhje me rrethanat.

## **TVSH e tarifueshme**

TVSH-ja ngarkohet me normë standarde prej tetëmbëdhjetë përqind (18%) dhe ngjarja për ngarkimin do të ndodhë dhe TVSH-ja do të bëhet e tarifueshme kur mallrat ose shërbimet janë furnizuar dhe mallrat janë importuar. Sidoqoftë, ligji për TVSH parashikon ngjarje specifike dhe zbritje në lidhje me natyrën dhe incidentet që mund të ndodhin gjatë ushtrimit të aktivitetit. Shkalla e zvogëluar e TVSH-së llogaritet dhe paguhet prej tetë përqind (8%) për furnizimin me mallra dhe shërbime si dhe importin e tyre, siç janë: furnizimi me ujë (përveç ujit në shishe), furnizimi me energji elektrike, drithërat, produktet e bëra nga drithërat për konsumin njerëzor, vajrat e gatimit, produktet e qumështit, pajisjet e teknologjisë së informacionit, furnizimi me ilaçe, pajisje mjekësore, etj. Megjithatë, për veprimtari specifike parashikohen trajtime dhe skema të veçanta, të tilla si skema me normë të sheshtë për fermerët, skema speciale për shërbimet e furnizuara në mënyrë elektronike, speciale skema për investimin në ar.

Për më tepër, mund të ndodhin përjashtime të shumëfishta për aktivitete të caktuara në interesin publik, siç janë transaksionet përkatëse: shërbime spitalore dhe kujdes mjekësor, furnizim me organe njerëzore, teknikë dentare në aftësinë e tyre profesionale, shërbime dhe mallra të lidhura ngushtë me mirëqenien dhe punën e sigurimeve shoqërore, shërbime që lidhen me edukimin dhe mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve, aktivitetet e kryera nga radio publike, gazeta dhe botime periodike, transport publik, etj.

## **Zbritja e TVSH-së**

E drejta për të zbritur TVSH-në lind kur TVSH bëhet e ngarkueshme. Një person i tatueshëm nuk mund të zbresë TVSH-në para periudhës tatimore në të cilën ai ka marrë fatura për mallrat ose shërbimet e furnizuara për të ose në të cilën ka marrë deklarata doganore për mallrat e importuara. Sidoqoftë, një person i tatueshëm nuk do të zbresë TVSH-në e hyrjes në jahte dhe anije të destinuara për sport dhe rekreacion, avionë privatë, makina dhe motoçikleta të përdorura vetëm për qëllime jo biznesi, lëndë djegëse dhe lubrifikantë dhe pjesë këmbimi dhe shërbime të lidhura ngushtë me to, përveç anijeve ose automjetet e përdorura për qira dhe qira dhe për rishitje, dhe automjetet e përdorura në autoshkolla për sigurimin e programit të trajnimit të shoferëve në përputhje me rregulloret. Përsa i përket kostove totale të blerjes dhe shpenzimet aktuale në lidhje me makinat e përdorura për qëllime private dhe në të njëjtën kohë për qëllime biznesi, e drejta për të zbritur TVSH-në lejohet deri në një maksimum prej pesëdhjetë përqind (50%).

## **Rimbursimi i TVSH-së**

Një person i tatueshëm mund të transferojë kredinë e tepërt të TVSH-së në periudhën vijuese tatimore ose mund të paraqesë një kërkesë për rimbursim të TVSH-së nëse personi i tatueshëm ka transferuar tepërcën e TVSH-së në blerje për tre (3) muaj rresht. Kthimi i TVSH-së i një personi të tatueshëm pasqyron një shumë të zbritshme që tejkalon shumën e detyrimit të TVSH-së. Kredia e tepërt e TVSH-së e bartur mund të zbatohet kundrejt detyrimit të TVSH-së në periudhat pasardhëse të taksave. Një person i tatueshëm mund të kërkojë një rimbursim të TVSH-së nëse për 3 muaj rresht është në kredi dhe në fund të muajit të tretë shuma e kreditit të TVSH-së tejkalon vlerën e 3,000 Eur dhe nëse të gjitha deklaratat e TVSH-së dhe tatimeve të tjera për të gjitha periudhat e kaluara tatimore kanë qenë paraqitur. Në një rast kur personi i tatueshëm ka eksportuar mund të kërkojë një rimbursim të TVSH-së pas çdo periudhe tatimore, me kusht që këto kushte të përmbushen: shuma e kredisë së TVSH-së tejkalon 3,000 Eur në fund të periudhës tatimore; personi i tatueshëm përputhet me të gjitha dispozitat e zbatueshme doganore dhe të TVSH-së, dhe të gjitha deklaratat e TVSH-së dhe deklaratat e tjera tatimore janë dorëzuar.

## **TATIMI I TË ARDHURAVE TË KORPORATAVE**

Personat në vijim do të jenë tatimpagues sipas këtij ligji:

- Një korporatë ose ndërmarrje tjetër afariste që ka statusin e personit juridik sipas ligjit në fuqi në Kosovë;
- Një organizatë biznesi që operon me asete publike ose shoqërore;
- Një organizatë e regjistruar si një organizatë joqeveritare sipas legjisllacionit përkatës që rregullon Regjistrimin dhe Funksionimin e Organizatave Jo-Qeveritare (OJQ) në Kosovë;
- Një person jorezident me një njësi të përhershme në Kosovë.

Objekti i tatimit për një tatimpagues rezident do të jetë e ardhura e tatueshme nga të ardhurat në Kosovë dhe të ardhurat nga burimi i huaj, ndërsa objekt i tatimit për një tatimpagues jo-rezident do të jetë e ardhura e tatueshme nga burimet e të ardhurave në Kosovë.

Të ardhurat e tatueshme për një periudhë të tatueshme do të nënkuptojnë ndryshimin midis të ardhurave bruto të marra ose të përlogaritura gjatë periudhës tatimore dhe zbritjeve të lejueshme sipas këtij ligji, ndërsa përjashtohen raste specifike siç janë të ardhurat e tatueshme nga projektet e ndërtimit afatgjata dhe kontratat; të ardhurat e tatueshme nga qiraja operationale dhe financiare; të ardhurat bruto nga interesi, që përfshijnë: interesat nga huatë e dhëna personave ose subjekteve; interesi nga obligacionet ose letrat me vlerë të lëshuara nga organizatat e biznesit; interes nga llogari (llogari kursimi) që gjenerojnë interes dhe që mbahen në banka dhe institucione të tjera financiare.

**Shkalla e tatimit mbi të ardhurat e korporatave do të jetë dhjetë përqind (10%) e të ardhurave të tatueshme.**

## **Pagesat e taksave**

Secili tatimpagues sipas këtij ligji do të bëjë çdo tre (3) muaj paradhënie të tatimit në një llogari të caktuar nga Administrata Tatimore në një bankë, ose institucion financiar, i licensuar nga Banka Qendrore e Kosovës më ose para 15 Prilli, 15 Korrik, 15 Tetor dhe 15 Janar në lidhje me tremujorin kalendarik që i paraprin këto data.



Tatimpaguesit me të ardhura bruto vjetore prej 30.000 € të cilëve nuk u kërkohet, ose nuk vendosin të paraqesin një deklaratë vjetore tatimore, duhet të bëjnë pagesat e mëposhtme për tremujorin:

- Tre përqind (3%) e të ardhurave bruto të çdo tremujori nga tregtia, transporti, bujqësia dhe aktivitete të ngjashme tregtare, por jo më pak se 37.5 Eur për tremujor;
- Nëntë përqind (9%) e të ardhurave bruto të çdo tremujori nga shërbimet, aktivitetet profesionale, argëtuese dhe të ngjashme, por jo më pak se 37.5 Eur për tremujor;
- Dhjetë përqind (10%) e të ardhurave neto nga qiraja për tremujorin, të ulur me çdo shumë të mbajtur gjatë këtij tremujori në vijim;
- Nëse një tatimpagues i siguruan nuk ka të ardhura gjatë një tremujori, nuk kërkohet asnjë pagesë, por tatimpaguesi duhet të paraqesë deklaratën e këstit të tremujorit për periudhën kur nuk ka asnjë detyrim tatimor.

Nëse një paradhënie nuk është bërë në kohë, ose në një shumë që është më e vogël se ajo që kërkohet, autoritetet do të vendosin një gjobë në një shumë të barabartë me normën e interesit në fuqi në kohën që do të bëhej pagesa e paradhënies. Nuk do të ketë shtesa të tjera të taksave, për pagesa paradhënie të vonuara ose jo të përshtatshme. Nëse pagesa, ose pagesa të korrigjuara, për këstet tremujore janë bërë në ose para datave të caktuara dhe një deklaratë përfundimtare, ose deklaratë përfundimtare e korrigjuar është bërë siç është kërkuar, asnjë gjobë nuk do të ngarkohet për pagesa të vonuara ose të pamjaftueshme të paradhënies, nëse:

- diferenca midis shumës që duhet paguar në secilën këst dhe shumës së paguar në secilën këst nuk e kalon njëzet përqind (20%) të shumës që duhet paguar;
- pas periudhës së parë tatimore të tatimpaguesit, shumata e paguar në secilën këst është të paktën dhjetë përqind (10%) më shumë se një e katërta (1/4) e detyrimit tatimor në deklaratën tatimore për periudhën e mëparshme tatimore;
- nëse autoritetet kryejnë një kontroll të ndonjë viti dhe bëjnë një rregullim të taksës së atij viti prej më shumë se njëzet përqind (20%), lehtësimi nga gjobat i dhënë më sipër nuk do të zbatohet për kërkesat e paradhënies për periudhën tatimore pasuese;
- për periudhën e parë tatimore gjatë së cilës një tatimpagues ka qenë në biznes, tatimpaguesi nuk do t'i nënshtrohet një ndëshkimi nëse paradhëniet tremujore përfshirë tremujorin e katërt përbëjnë më shumë se tetëdhjetë përqind (80%) ose më shumë e taksës përfundimtare të detyrueshme për atë periudhë tatimore;
- një tatimpagues që ka pasur një humbje në deklaratën e tatimit mbi të ardhurat e korporatave të vitit paraprak nuk ka të drejtë të përdorë provigjionet në kryerjen e paradhënieve për vitin aktual.

## **Përjashtimet nga të ardhurat nga taksat e korporatave**

Sidoqoftë shumë të ardhura parashikohet të përjashtohen si:

- të ardhurat e organizatave të regjistruara nën Legjislacionin për Regjistrimin dhe Funksionimin e organizatave joqeveritare që kanë marrë dhe mbajtur statusin e përfitimit publik në masën që të ardhurat të përdoren ekskluzivisht për qëllime të përfitimit publik;
- të ardhurat e Bankës Qendrore të Kosovës dhe të atyre të institucioneve financiare qeveritare ndërkombëtare të autorizuara që veprojnë në Kosovë;
- interesi për instrumentet financiare të cilat janë lëshuar, ose garantuar, nga një autoritet publik i Kosovës, i paguar kundrejt tatimpaguesve rezidentë ose jorezidentë;
- të ardhurat e bashkësive fetare sipas Ligjit për Lirinë Fetare në Kosovë;
- të ardhurat e kontraktuesve kryesorë ose nënkontraktuesve, përveç një personi lokal, të krijuara nga kontratat për furnizimin e mallrave ose shërbimeve për Kombet e Bashkuara, Agjencitë e Specializuara të Kombeve të Bashkuara, KFOR dhe Agjencinë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike me kushtin e angazhimit të drejtpërdrejt në projektet dhe programet e organizatave të përmendura më sipër;
- të ardhurat e një kontraktori kryesor ose një nënkontraktori, të ndryshëm nga personi lokal, të krijuara nga kontrata me qeveritë e huaja, organet dhe agjencitë e tyre, Bashkimin Evropian, Agjencitë e Specializuara të Bashkimit Evropian; Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe organizatat ndërkombëtare ndërqeveritare për furnizimin e mallrave ose shërbimeve në mbështetje të programeve dhe projekteve për Kosovën;



- të ardhurat e marra nga grantet, subvencionet dhe donacionet në përputhje me rregullat dhe kushtet për përfitim;
- dividendi i paguar ose i marrë për personin rezident dhe jorezident.

## **Shpenzimet e palejuara**

Gjatë përcaktimit të të ardhurave të tatueshme, disa prej shpenzimeve janë të palejueshme si: kostoja e blerjes dhe përmirësimit të tokës; kostoja e rinovimit dhe rindërtimit të pasurive që kapitalizohen dhe zhvlerësohen; gjobat dhe llojet e interesave; tatimet mbi të ardhurat e paguara ose të përlogaritura për periudhën aktuale ose të mëparshme tatimore dhe interesat mbi to; kontributet e pensionit mbi shumën maksimale të lejuar; shpenzimet për dhurata, humbjet në peshë ose material specifik; dëmet, mbetjet, tepricat; fitimet në natyrë siç janë vaktet dhe transporti; shpenzimet për marrjen me qira të apartamenteve të përdorura për akomodimin e punonjësve; shpenzimet e mbuluara nga grante, donacione dhe subvencione; shpenzimet për argëtim dhe rekreacion; etj.

## **Zbritjet e lejuara**

### Aktivite me interes publik

Kontributet e bëra nga tatimpaguesit që mbajnë librat dhe regjistrimet në formën e një donacioni dhe sponsori për qëllime humanitare, shëndetësore, arsimore, fetare, shkencore, kulturore, mbrojtjen e mjedisit dhe sportit, sipas këtij ligji konsiderohen si kontribut i paguar për interes publik dhe lejohet të trajtohen si shpenzime deri në një maksimum prej dhjetë përqind (10%) të të ardhurave të tatueshme të llogaritura para se të zbriten kontributet e bamirësisë. Një zbritje e lejueshme nuk do të përfshijë një kontribut që drejtpërdrejt, ose indirekt, përfiton nga donatori ose personat e lidhur me të nga donatori.

### Shpenzimet e përfaqësimit, reklamës dhe promovimit ekonomik

Shpenzimet e përfaqësimit përfshijnë shpenzime të karakterit të përgjithshëm që një person biznesi ka kryer për qëllime të një prezantimi në lidhje me partnerët e tij ose institucione të tjera, të tilla si: organizimi i takimeve, prezantimi i projekteve të reja, inagurimi i linjave ose produkteve të reja, trajtimet dhe pritjet në lidhje me aktivitetin e biznesit. Shpenzimi i përfaqësimit është i kufizuar në një përqind (1%) të të ardhurave bruto vjetore. Ndërsa shpenzimet e reklamimit dhe promovimit të kryera në pika të ndryshme informacioni si: televizion, radio, gazeta, revista, reklama direkte, internet, postera, fletëpalosje, tabela, reklama tranziti dhe të ngjashme, janë shpenzime plotësisht të zbritshme për qëllime tatimore.

### Borxhi i keq

Zbritjet e borxheve të këqija janë të kufizuara në pjesën e pashlyer të borxhit. Çdo borxh i keq i zbritur si shpenzim dhe më pas i mbledhur më pas do të përfshihet në të ardhurat e tatimpaguesit në kohën e mbledhjes. Ndërkohë, borxhi i keq deri në 500 Eur konsiderohet të zbritet pa nevojën e fillimit të procedurave gjyqësore.

### Provizione për humbjet e pritshme të huave, provizione teknike dhe matematikore

Provizionet për humbjet e pritshme nuk lejohen si shpenzime të zbritshme në përcaktimin e të ardhurave të tatueshme përveç rasteve të tilla si:

Bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare të licencuara nga BQK-ja për përcaktimin e të ardhurave të tatueshme kanë të drejtë të njohin si shpenzime të zbritshme provizionin për humbjet e pritshme nga kreditë deri në tetëdhjetë përqind (80%) të shumës së përcaktuar nga një nën-akti juridik i nxjerrë nga BQK-ja.

Institucionet e sigurimeve financiare dhe risigurimeve të licencuara nga BQK-ja, në përcaktimin e të ardhurave të tatueshme, kanë të drejtë të njohin shpenzimet e zbritshme për rezervat teknike dhe matematikore deri në tetëdhjetë përqind (80%) të shumës së përcaktuar nga Ligji i Sigurimeve dhe aktet nënligjore të nxjerra nga BQK-ja.

### Shtesa të veçanta për aktivet e reja

Nëse një tatimpagues ble linja prodhimi për impiantet dhe makineritë, inventarin hekurudhor dhe lokomotivat e përdorura për transportin hekurudhor, aeroplanë, anije, automjete të rënda transporti,

pajisje për lëvizjen e tokës, buldozerë, pajisje për përpunimin e skrapit dhe mjete të tjera të rënda për qëllimin e aktivitetit ekonomik të tatimpaguesit, përveç zhvlerësimit normal të lejuar, një zbritje speciale prej dhjetë përqind (10%) e kostos së blerjes së pasurisë do të lejohet në vitin në të cilin aktivi është vendosur për herë të parë në punë.

### **Transferimi i çmimit, shmangia e taksimit të dyfishtë**

Një tatimpagues që i nënshtrohet tatimit mbi të ardhurat e korporatave dhe që merr pjesë në një ose më shumë transaksione të kontrolluara do të përcaktojë fitimin e tatueshëm në përputhje me vlerën e hapur të tregut për çmimet e transferimit. Vlera e tregut të hapur për qëllimin e transferimit të çmimit - parimi i tregut - do të thotë parimi kur kushtet të tilla janë krijuar ose vendosur ndërmjet dy ndërmarrjeve, në marrëdhënie tregtare ose financiare, të cilat ndryshojnë nga ato që do të ishin krijuar midis ndërmarrjeve të pavarura, ku çdo fitim që do të kishte rezultuar në ndonjë nga ndërmarrjet, për shkak të kushteve të tilla nuk është krijuar, do të jetë i kualifikuar për t'u përfshirë në fitimet e ndërmarrjes dhe të tathet në përputhje me këtë fitim. Korrektimet përkatëse - kur në kushte të transaksioneve të kontrolluara bëhet një rregullim nga autoriteti tatimor i një vendi tjetër dhe ky rregullim rezulton në tatimin e fitimeve në atë vend për të cilin tatimpaguesi tashmë tathet në Kosovë, dhe vendi që propozon rregulloren ka një marrëveshje për eliminimin e taksimit të dyfishtë me Kosovën, atëherë në këto kushte ATK, me paraqitjen e një kërkesë nga tatimpaguesi kosovar, do të kontrollojë pajtueshmërinë e asaj rregulloreje me vlerën e tregut të lirë.

### **Mbajtja në burim e pagesave të caktuara për jorezidentët**

Të ardhurat që i atribuohen një entiteti jorezident në Kosovë me funksion argëtues, siç është teatri, filmi, artisti i radios ose televizionit, një këngëtar ose muzikant, ose si një sportist, të gjeneruara nga aktivitetet e tij personale të ushtruara në Kosovë, do të jenë subjekt i mbajtjes në burim nga paguesit e këtyre të ardhurave, pavarësisht nëse paguhen direkt ose indirekt tek entiteti jorezident. Pavarësisht nga ndonjë dispozitë tjetër për ligjin mbi tatimin mbi të ardhurat e korporatave, shuma e mbajtjes në burim do të jetë pesë përqind (5%) e kompensimit bruto. Secili pagues duhet të paraqesë një deklaratë të mbajtjes në burim dhe të dërgojë shumën e tatimit të mbajtur në një llogari të caktuar nga Administrata Tatimore në një bankë të licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas ditës së fundit të çdo muaji kalendarik, në përputhje me një akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri. Secili pagues, i cili mban tatim n; burim gjatë një periudhe tatimore, me kërkesë të marrjes së faturës të të ardhurave, para 1 marsit të vitit pas periudhës tatimore, do t'i sigurojë një vërtetim të mbajtjes në burim të tatimit marrësit të të ardhurave në formën e specifikuar me një akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri.

### **Rezultatet e sondazhit**

Bazuar në rezultatet e grumbulluara të të anketuarve, është vlerësuar një kontribut i përafërt i këtyre kompanive në buxhetin fiskal të vendit. Në vlerësimin e kontributit të nënkuptuar të të ardhurave nga tatimi i korporatave, janë nxjerrë marzhet mesatare të Fitimit Para Taksave, të cilat konsiderohen përfaqësuese në industrinë/sectorin ku operojnë kompanitë, dhe është aplikuar norma e tatimit prej 10% në Kosovë. Për më tepër, bazuar në qarkullimin mesatar vjetor të ndërmarrjeve, kontributi i grumbulluar i TVSH-së (në shitje) vlerësohet të jetë 26 milion EUR në bazë vjetore.

Për më tepër, duke marrë parasysh një kapital total të investuar c. 238 mln euro, kontributi i TVSH-së së nënkuptuar nga investimet vlerësohet të jetë rreth 43 milion EUR.

Duke qenë se ndërmarrjet pjesëmarrëse në sondazh kanë punësuar një numër të përgjithshëm prej 1,102 punonjës, Ndikimi i Nënkuptuar i Kontributit Social vlerësohet të jetë rreth 411 mijë EUR, në bazë vjetore.

(Ju lutemi referojuni Shtojcës 6 për më shumë detaje mbi llogaritjet e kontributeve fiskale)

	Të ardhurat totale	Totali i shpenzimeve kapitale të investuara	Kontributi i nënkuptuar i tatimit mbi të ardhurat e korporatave	TVSH mbi shitje	TVSH mbi shpenzimet kapitale	Nr. i punonjësve	Impakti i nënkuptuar i kontributit social
EURO	145,734,616	238,584,200	4,471,862	26,232,231	42,945,156	1,102	411,166

Burimi: Analizë e sondazhit

\* Analiza e mësipërme është një tregues i ndikimit të pritur dhe bazohet vetëm në të dhënat e nxjerra nga studimi. Të dhëna të tilla nuk janë verifikuar nga burime të pavarura dhe për qëllimin e analizës së mësipërme konsiderohen të sakta.

# **NDIKIMI I INVESTIMEVE GJERMANE DHE TË DIASPORËS NË EKONOMINË E KOSOVËS**

Një nga pjesët thelbësore të këtij raporti, është vlerësimi i ndikimit që investimet gjermane kanë pasur në ekonominë e Kosovës. IHD-të konsiderohen të jenë një kontribues i rëndësishëm në rritjen ekonomike për shkak të potencialit për të rritur produktivitetin dhe inovacionin, për të krijuar punësim dhe për të sjellë përfitime të tjera ekonomike. Ky seksion identifikon faktorë të ndryshëm ekonomikë që janë të rëndësishëm për t'u konsideruar kur vlerësohet ndikimi i IHD-ve në ekonominë e Kosovës. Për më tepër, një analizë ekonometrike është performuar për të vlerësuar ndikimin që IHD-të kanë në faktorët e identifikuar të ndikimit ekonomik në bazë të të dhënave vjetore historike në Kosovë midis 2010 dhe 2019.

Treguesit e mëposhtëm ekonomikë janë zgjedhur për të qenë pjesë e analizës:

- Vlera e shtuar bruto (GVA)
- PBB për frymë
- Shkalla e punësimit
- Paga mesatare

Shtrirja kohore: Të dhënat për të gjithë treguesit ishin të disponueshëm vetëm për periudhën 2010-2019<sup>1</sup>.

Analiza është kryer mbi IHD-të totale në vend, me variabla që pasqyrojnë të gjithë ekonominë e Kosovës. Kjo qasje zgjidhet në mënyrë që të rezultojnë vlerësime dhe koeficientë të besueshëm të secilin prej treguesve. Këta koeficientë do të aplikohen posaçërisht për investimet gjermane në Kosovë.

Kur vlerësohet ndikimi në ndonjë faktor të caktuar të ndikimit ekonomik, është e rëndësishme të bëhet dallimi midis efektit direkt dhe indirekt. Efekti i direkt përshkruan ndikimin e menjëhershëm të IHD-ve që ndodhin; për shembull, numri i punonjësve të punësuar për funksionimin e biznesit, pagat që kompania e huaj u paguan punonjësve të tyre, shuma e shpenzuar për Kerkim dhe Zhvillim (R&D) etj. Efekti indirekt tregon ndikimin që IHD-ë kanë pasur në të gjitha kompanitë e tjera në sektor, qoftë përmes konkurrencës ose efektit demonstrues. (Burimi: Vlerësimi i ndikimit ekonomik të IHD-ve për të mbështetur strategjinë e promovimit të Departamentit për Tregtinë Ndërkombëtare; Qershor 2018)

Analiza identifikon ndikimin indirekt të IHD-ve në secilën prej variablave me interes më vete dhe nuk vlerëson ndikimin që këto variabla kanë mbi njëri-tjetrin. Analiza e regresionit siguron një mjet të fuqishëm kur vlerësohen efektet indirekte. Modelet e regresionit linear janë kryer në Programimin R në mënyrë që të analizohet ndikimi i IHD-ve në secilin prej faktorëve të ndikimit. Përmbledhja e hollësishme e analizës së regresionit gjendet në Shtojcën 1.

Me qëllim mbështetjen e analizës së kryer të regresionit e cila është bazuar në të dhënat në sasi të vogël të faktorëve të ndikimit në Kosovë, është kryer një analizë regresioni në një bazë të dhënash shumë më të madhe në një vend të ngjashëm me Kosovën. Analiza për të njëjtët faktorë është kryer bazuar në të dhënat historike të IHD-ve në Shqipëri midis 1996 dhe 2019, në mënyrë që të kemi një model regresioni të krahasueshëm më të plotë. Rezultatet e analizës së regresionit të kryer në të dhënat e Shqipërisë ishin të ngjashme me rezultatet e analizës së të dhënave të Kosovës, duke mbështetur përfundimet e arritura në modelet e Kosovës.

## **Kufizimet**

Për shkak të kufizimit të të dhënave, analiza e regresionit për ndikimin e IHD-ve në ekonominë e Kosovës është kryer mbi një bazë të vogël të të dhënave, duke ndikuar kështu në besueshmërinë e modelit. Pas kryerjes së regresionit të të njëjtit model me një bazë të dhënash shumë më të madhe (të dhënat e Shqipërisë) dhe arritjes së përfundimeve të ngjashme, mund t'i referohemi në mënyrë të besueshme modelit të Kosovës. Për më tepër, duke qenë se regresion linear është kryer për të matur ndikimin indirekt të IHD-ve në secilin prej variablave me interes dhe nuk është vlerësuar ndikimi që kanë këto

<sup>1</sup> Përveç GVA, të dhënat për të cilën janë të disponueshme deri në vitin 2018.

variabla mbi njëri-tjetrin, vlerat e R-Katrorit priten më të ulta se 90%, për shkak se një faktori ekonomik ndikohet nga shumë faktorë të tjerë njëkohësisht.

## Rezultatet

### Koeficientët e analizës së regresionit (Shqipëri)

Faktori i ndikimit	Vlera P	R katrori i korrektuar	Koeficienti i Interceptit	Koeficienti i stokut të IHD-ve	Ekuacioni i regresionit
GVA (Vlera Bruto e Shtuar)	0.000006	0.60	4,758.3506	1.423772	$y=1.423772x+4758.350625$
PBB për frymë	0.000000	0.86	3,730.5782	1.765284	$y=1.765284x+3730.578181$
Pagat mesatare	0.000000	0.69	120.9680	0.060845	$y=0.06084468x+120.96801808$
Shkalla e punësimit	0.005288	0.24	0.5035	(0.000007)	$y=-0.000006597213x+0.5034627$

Burimi: Analizë e Regresionit

Analiza që vlerëson efektin indirekt të IHD-ve gjatë viteve 1996-2019, tregon se një rritje prej 1 milion USD në stokun e IHD-ve në Shqipëri çon në:

Shprehur në USD	Shprehur si % e mesatares së faktorit gjatë periudhës së studimit
<ul style="list-style-type: none"> <li>një rritje në GVA mesatare vjetore me rreth 1.4238 milion USD;</li> <li>një rritje në PBB mesatare vjetore për frymë me rreth 1.7653 dollarë amerikanë;</li> <li>një rritje në pagën mesatare vjetore me rreth 0,0608 USD;</li> <li>një rënie në normën mesatare vjetore të punësimit me rreth 0.000007%.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>një rritje në GVA mesatare me rreth 0.0179%;</li> <li>një rritje në PBB mesatare për frymë me rreth 0.0243%;</li> <li>një rritje në pagën mesatare me rreth 0.0250%;</li> <li>një rënie në shkallën mesatare të punësimit me rreth 0.0013%;</li> </ul>

Analiza që vlerëson efektin indirekt të IHD-ve gjatë 2010-2019, tregon se një rritje prej 1 milion USD në stokun e IHD-ve në Kosovë çon në një rritje neto në:

### Koeficientët e analizës së regresionit (Kosovë)

Faktori i ndikimit	Vlera P	R katrori i korrektuar	Koeficienti i Interceptit	Koeficienti i stokut të IHD-ve	Ekuacioni i regresionit
GVA (Vlera Bruto e Shtuar)	0.000888	0.79	928.9167	1.000351	$y=1.000351x+928.916727$
PBB për frymë	0.000303	0.80	412.3716	0.759889	$y=0.7598889x+412.3716492$
Pagat mesatare	0.000289	0.80	174.8792	0.046542	$y=0.04654216x+174.87921996$
Shkalla e punësimit	0.002351	0.67	0.2994	0.000101	$y=0.0001006323x+0.2994014083$

Burimi: Analizë e Regresionit

Shprehur në USD	Shprehur si % e mesatares së faktorit gjatë periudhës së studimit
<ul style="list-style-type: none"> <li>një rritje në GVA mesatare vjetore me rreth 1.0004 milion USD;</li> <li>një rritje në PBB mesatare vjetore për frymë me rreth 0.7599 USD;</li> <li>një rritje në pagën mesatare vjetore me rreth 0.0465 USD;</li> <li>një rritje në normën mesatare vjetore të punësimit me rreth 0.0001%</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>një rritje në GVA mesatare me rreth 0.0223%;</li> <li>një rritje në PBB mesatare për frymë me rreth 0.0238%;</li> <li>një rritje në pagën mesatare me rreth 0.0135%;</li> <li>një rënie në shkallën mesatare të punësimit me rreth 0.0151%;</li> </ul>

Koeficienti i shkallës së punësimit në të dy rastet ka treguar një R-Katror më të ulët krahasuar me treguesit e tjerë.

Prandaj, ky faktor konsiderohet që të mos jetë përfaqësues për qëllimin e analizës sonë, duke marrë parasysh që treguesi i punësimit mund të ketë lidhje edhe me trende dhe variabla të tjerë si reformat në politikat e tregut të punës, punëtorët sezonalë jashtë vendit etj.

### **Rezultatet e sondazhit\***

Nga të dhënat e të anketuarve, kapitali i përgjithshëm që kompanitë të cilat ishin pjesë e anketës kanë investuar në Kosovë, arrin në rreth 285 mln euro. Këto kompani kanë një numër të përgjithshëm të punonjësve prej 1,102. Duke marrë parasysh koeficientët që rezultojnë nga analiza e regresionit, mund të nxirret një përafrim i kontributit që këto kompani kanë pasur në rritjen e GVA, PBB/Fryme dhe pagën mesatare.

<b>Totali i shpenzimeve kapitale të investuara</b>	238,584,200		
<b>Nr. total i punonjësve</b>	1,102		
<b>Paga mesatare (EURO)</b>	311		
		<b>Impakti i GVA (Vlera Bruto e shtuar)</b>	<b>Paga Mesatare</b>
Faktori (EURO për 1 EURO shpenzime kapitale)		1.1965	0.00000015
Vlera totale e nënkuptuar e impaktit (EURO)		<b>285,458,978</b>	<b>354</b>
Burimi: Analizë e Regresionit			<b>12.19</b>

\* Analiza e mësipërme është një tregues i ndikimit të pritur dhe bazohet vetëm në të dhënat e nxjerra nga studimi. Të dhëna të tilla nuk janë verifikuar nga burime të pavarura dhe për qëllimin e analizës së mësipërme konsiderohen të sakta.



## **OPORTUNITETET E INVESTIMIT NË KOSOVË**

Pas pavarësisë, Kosova ka bërë progres në shumë fusha të zhvillimit të saj si ngritja e nivelit të sigurisë, rritja e stabilitetit politik, ekonomia e qëndrueshme me rritje të vazhdueshme etj.

Përmes iniciativave të bashkëpunimit rajonal, Kosova ka arritur të jetë pjesë e një tregu të përbashkët rajonal, të eliminojë tarifatat doganore dhe të hapë perspektiva të reja. Institucionet e Kosovës po punojnë vazhdimisht për të përmbushur standardet e kërkuara nga Bashkimi Evropian.

Kosova ka arritur progres në infrastrukturë, ku më të rëndësishmet janë lidhja me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut përmes autostradave moderne. Autostrada me Shqipërinë ka një rëndësi të konsiderueshme, duke konsideruar që Kosova ka kështu akses në portin Adriatik përmes të cilit është e lidhur me detin.

Ka shumë përfitime për investitorët e mundshëm nga investimi në Kosovë. Disa nga këto përfitime janë taksa të ulta krahasuar me fqinjët, popullsia e re dhe e motivuar, ku 70 përqind janë në moshën nën 35 vjeç, qasje e lirë në tregun e Bashkimit Evropian dhe tregjet fqinje, sistem të sigurt bankar, mungesë e rrezikut të monedhës për vendet e BE duke përdorur monedhën e përbashkët Euro, institucione moderne në mbështetje të bizneseve etj.

Duke analizuar të gjithë këta faktorë, Kosova paraqet disa sektorë me potencial të lartë për të ardhmen si agrikultura dhe bujqësia, teknologjia e informacionit dhe komunikimit, energjia dhe minierat, turizmi dhe industria tekstile.

### **Agrikultura dhe bujqësia**

<b>Situata aktuale</b>
<ul style="list-style-type: none"><li>• Kosova është e pasur me tokë bujqësore. 588,000 ha ose 53% e sipërfaqes totale është tokë e punueshme dhe aktualisht 260,000 ha përdoret si tokë bujqësore.</li><li>• Kosova ka një traditë bujqësore sepse 60% e popullsisë jeton në zona rurale dhe kryesisht punon në bujqësi.</li><li>• Kontributi i bujqësisë në PBB është 14.5% dhe është burimi kryesor i të ardhurave për shumicën e popullsisë.</li><li>• Bujqësia kontribuon me 13% në vlerën e eksporteve dhe është një nga ofruesit më të rëndësishëm të punësimit në Kosovë.</li><li>• Toka e punueshme në Kosovë e kombinuar me klimën sigurojnë kushte të mira për prodhimin bujqësor, e megjithatë 70% e kërkesës së tregut lokal për produktet bujqësore është e garantuar nga importet.</li><li>• Fushat më të rëndësishme të bujqësisë në Kosovë janë ato të perimeve dhe drithërave.</li></ul>
<b>Perspektiva në të ardhmen</b>
<ul style="list-style-type: none"><li>• Kosova ofron fuqi punëtore me kosto efektive dhe ofron qasje falas në tregun rajonal të përbërë nga më shumë se 30 milion konsumatorë. Kjo strukturë vjen si pasoje e liberalizimit të tregtisë brenda rajonit të CEFTA-s. Ka vetëm disa produkte të përjashtuara nga ky trajtim preferencial.</li><li>• USAID mbajti një studim që zbuloi mundësi të reja për rritje në tetor 2009. Studimi tregoi se mund të rriten gjithsej 105 të korra.</li><li>• Kosova është e mirënjohur si prodhuese e llojeve të ndryshme të rrushit. Lartësia prej 300-400 metra mbi nivelin e detit dhe klima kontinentale sigurojnë kushte shumë të mira për vreshtat dhe zhvillimin dhe rritjen e rrushit për verë.</li><li>• Janë pothuajse 200 ditë me diell çdo vit për të ndihmuar në rritjen e rrushit. Këto përparësi krijojnë kushte shumë të mira për prodhimin cilësor të verës në Kosovë.</li><li>• Kosova gjithashtu ofron kushte ideale për blegtori, për shkak të vendndodhjes së saj gjeografike. Ekzistojnë dy faktorë kryesorë në favor të investimeve të bagëtive në Kosovë.<ul style="list-style-type: none"><li>a) Kushte të mira natyrore dhe klimatike për shumë lloje të blegtorisë.</li><li>b) Kërkesa e tregut për produktet e blegtorisë është shumë më e lartë se prodhimi vendas.</li></ul></li><li>• Zhvillimi i industrisë së përpunimit të ushqimit do të krijojë më shumë mundësi për blegtori në të ardhmen.</li><li>• Rihapja e tregjeve të eksportit është pengesa kryesore për kompanitë e përpunimit të mishit në Kosovë.</li></ul>

- Vendndodhja gjeografike pranë vendeve jo-anëtare të BE-së si Shqipëria, Mali i Zi, Bosnje-Hercegovina dhe Turqia, mund të ofrojë një zgjidhje afatshkurtër me fokus fillestar në eksportet e mishit në këto destinacione, me mundësinë e zgjerimit në tregjet e BE-së.

Burimi: Agjencia e Kosovës për Investime dhe Ndërmarrje, Dhjetor 2020

## Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (ICT)

### Situata aktuale

- Aksesimi në internet është rritur në Kosovë gjatë viteve të fundit, dhe pjesa më e madhe e popullsisë ka lidhje interneti. Sidoqoftë, 38.7% e popullsisë së vendit ende nuk ka qasje në asnjë lloj pajisje elektronike kompjuterike.
- Kompanitë kosovare në sektorin e ICT ofrojnë sot teknologjitë më të fundit dhe shërbime me cilësi të lartë për klientët e tyre. Këto kompani ofrojnë shërbimet e tyre si për kompanitë vendase ashtu edhe për ato të huaja që duan të transferojnë zhvillimin e sistemeve të tyre.
- Kërkesa për trajnim në sektorin e ICT po rritet vazhdimisht. Institucionet arsimore publike dhe private në fushën e ICT, ofrojnë arsimim për mijëra të rinj kosovarë, ndërsa kompanitë kosovare ofrojnë shërbime me cilësi të lartë dhe kosto të ulët. Këto shërbime mbështeten nga kompani të tilla si CISCO ose Microsoft.
- Sektori i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit konsiderohet si një nga sektorët e paktë me një bilanc tregtar pozitiv sipas raportit të ICT Barometer të Shoqatës së Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit të Kosovës në 2018.
- Gjatë vitit 2018, 78% e ndërmarrjeve të ICT në Kosovë eksportuan shërbimet dhe produktet e tyre, një ndryshim i madh krahasuar me vitin 2017 kur eksporti i shërbimeve të tyre nga kompanitë e ICT-së ishte vetëm 58%.
- Pagat mujore për profesionet e ICT u rritën me 4% gjatë viteve të fundit.
- Një sondazh i kryer nga PWC në vitin 2018 për bizneset e ICT tregoi se 72% e të anketuarve mendojnë se gjetja e punëtorëve të kualifikuar është një sfidë e madhe, pavarësisht një shkalle papunësie prej 31.4% në vend në 2018.
- 43% e të anketuarve nuk janë të kënaqur me politikën aktuale dhe mjedisin rregullator dhe zhvillimet.
- 58% e të anketuarve mendojnë se cilësia e shkollave dhe trajnimeve për njerëzit që punojnë në sektorin e teknologjisë dixhitale është e pamjaftueshme.
- Pengesat kryesore në tregjet e sektorit ICT sipas presidentit të Shoqatës së Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit të Kosovës janë gjetja e partnerit të duhur të biznesit, kërkesat për viza dhe mungesa e kontakteve të biznesit të targetuar - 88% e bizneseve në sektorin e ICT janë në pronësi të vendit, me vetëm 8% e kompanive janë në pronësi të huaj.
- 87% e bizneseve të ICT janë në pronësi të meshkujve. Kjo gjithashtu reflektohet në fuqinë punëtore të sektorit ku ka një raport 80/20 të punonjësve meshkuj dhe femra.

### Perspektiva në të ardhmen

- Zhvillimi i sektorit të ICT në Kosovë është bërë një nga përparësitë kryesore të qeverisë gjatë pesë viteve të fundit.
- Universitetet janë të nënfinancuara dhe kërkojnë investime të konsiderueshme. Ata prodhojnë rreth 350 të diplomuar të ICT në vit dhe 91% e të anketuarve në sondazhin e kompanive ICT pajtohen që programet arsimore janë të papërshtatshme dhe nuk plotësojnë aftësitë dhe kërkesat e sektorit.
- Kosova ka popullsinë më të re në Evropë, ku 70% e popullsisë është në moshën nën 35 vjeç.
- Shumë kosovarë që kanë studiuar jashtë tani po kthehen në Kosovë, duke sjellë me vete aftësi dhe njohuri teknike.
- Sipas hulumtimit të BuddeComm, duke analizuar shërbimin e Telekom, Mobile dhe Broadband në Kosovë pritet që në vitin 2021 abonentët telefonik do të arrijnë 2.3 milion, duke shfaqur një rritje me 3.1% në krahasim me 2020.
- Shkalla e penetrimit të abonentëve celularë, e cila përfaqëson numrin e përgjithshëm të lidhjeve të kartave SIM në një vend si përqindje e popullsisë së përgjithshme të atij vendi, pritet të rritet nga 117.4% në vitin 2020 në 119.1% në 2021. Në planin afatgjatë, gjatë 2024 parashikohet të jenë 2.7 milion abonentë celularë dhe shkalla e penetrimit të jetë 126.2%.

Burimi: Agjencia e Kosovës për Investime dhe Ndërmarrje, Dhjetor 2020



## Energjia dhe minierat

### Situata aktuale

- Kosova ka 14,700 milion ton rezerva linjiti dhe posedon rezervat e pestë më të mëdha të linjtit në botë. Rezervat e këtij minerali vlerësohet të zgjasin për 650 vitet e ardhshme. Linjiti përdoret si burimi kryesor i prodhimit të energjisë në Kosovë.
- Në kulmin e prodhimit në vitet 1960 dhe 1970, Trepça punësoi mbi 22,000 punëtorë në të gjithë ish-Jugosllavinë.
- Termocentralet prodhojnë 98% të energjisë elektrike në Kosovë.
- Miniera e metaleve bazë ka qenë e rëndësishme për ekonominë e Kosovës që nga koha para-romake dhe minierat moderne filluan në 1930.
- Rezervat e zinkut dhe plumbit në Kosovë vlerësohet të jenë rreth 48 milion ton, ato të nikelit deri në 16 milion ton. Rezervat e kromit vlerësohen të jenë 89 milion ton dhe rezervat e boksiteve vlerësohen në 13.2 milion ton.
- Ekzistojnë miniera të ndryshme që mund të blihen përmes procedurave të privatizimit ose mund të organizohen duke hyrë në ndërmarrje të përbashkëta me pronarë privatë.

### Perspektiva në të ardhmen

